




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Ndihma e huaj në Shqipëri



Raporti i Progresit
2009-2010



**Departamenti i Bashkërendimit
të Strategjive dhe Koordinimit
të Ndhmës së Huaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Ndihma e huaj në Shqipëri

Raporti i Progresit 2009-2010

**Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe
Koordinimit të Ndhmës së Huaj**

Shtator 2011

Përmbajtja

SHKURTIME	4
PARATHËNIE	7
METODOLOGJIA	8
FALENDERIME	8
PRIRJET E PËRGJITHSHME TË NDIHMËS SË HUAJ	9
PËRBËRJA E NDIHMËS SË HUAJ	10
Sipas llojeve	10
Sipas donatorëve	13
Sipas sektorëve	15
Sipas statusit	16
Investimet publike me financim të brendshëm	17
DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS	19
DREJTËSIA DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME	23
EKONOMIA E TREGUT	30
INFRASTRUKTURA	38
ZHVILLIMI SOCIAL	48
ZHVILLIMI URBAN, RURAL DHE RAJONAL	57
PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ	63
SHTOJCAT	66

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BEI	Banka Europiane e Investimeve
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BIZh	Banka Islamike për Zhvillim
CARDS	Ndihma Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CBA	Projekti Cilësi dhe Barazi në Arsim
CEB	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës
DFID	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
EAMIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Ndhmën e Huaj
EIDHR	Instrumenti European për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut
EURALIUS	Misioni i Asistencës Europiane për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri
FAO	Organizata për Ushqimin dhe Bujqësinë
FTI-DOL	Iniciativa e Pistës së Shpejtë mbi Ndarjen e Punës
FDI	Investimet e Huaja Direkte
FTI-DOL	Iniciativa e Pistës së Shpejtë mbi Ndarjen e Punës
GEF	Shërbimi i Mjedisit Global
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IFAD	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IFN	Institucioni Financiar Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IMOC	Konsorcium Ndërkombëtar
KE	Komisioni European
KN	Konsorciumi Ndërkombëtar
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PVH	Plani i Veprimit për Harmonizim
PZhI	Partnerët për Zhvillim dhe Integrim
QSh	Qeveria e Shqipërisë
STD	Sekretariati Teknik i Donatorëve
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
Ministri, Departamente dhe Agjenci e Njësi të tjera qeveritare	
AIDA	Agjencia Shqiptare për Investime dhe Zhvillim
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit Territorial
AKShI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale

APP	Agjencia për Prokurimin Publik
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
FShZh	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
ITAP	Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike
KESH	Korporata Energjetike Shqiptare
KM	Këshilli i Ministrave
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MADA	Agjencia për Zhvillimin e Zonave Malore
MASh	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritit European
MITIK	Ministria për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPÇSSHb	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
PSHSH	Policia e Shtetit Shqiptar
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

PARATHËNIE

Qeveria shqiptare po demonstroi vullnet të fuqishëm për të vazhduar qasjen proaktive në lidhje me menaxhimin e ndihmës së huaj, paralelisht me rritjen e shkallës së pjekurisë dhe përmirësimin e proceseve të planifikimit strategjik dhe të monitorimit, në kuadrin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Për të përmirësuar monitorimin, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON) e ka bërë traditë publikimin e **raportit vjetor për ecurinë e ndihmës së huaj**. Kjo nismë që synon të rrisë transparencën për financimet e huaja dhe të forcojë rolin e Qeverisë në bashkërendimin e ndihmës së huaj, është në linjë me ndërgjegjësimin global që e konsideron bashkërendimin e donatorëve të lidhur ngushtë me përdorimin sa më të efektshëm të ndihmës, siç parashtrohet edhe në Deklaratën e Parisit për Efektivitetin e Ndhmës, ku Shqipëria është një nga vendet nënshkruese.

Ndërkohë që zhvillimi i përgjithshëm në Shqipëri përparon, është fakt tashmë që ndihma zyrtare për zhvillim (NZZh) me bazë granti po shënon rënie të vazhdueshme. Nga ana tjetër, zhvillimi i qëndrueshëm afatgjatë dhe i balancuar, si edhe integrimi i ekonomisë shqiptare në BE, kërkojnë arritjen e efikasitetit maksimal prej investimit të fondeve të brendshme dhe të huaja. Nisur nga përvoja e zgjerimit të fundit të BE-së, ritmi i Shqipërisë për arritjen e standardeve të BE-së do të varet shumë nga rritja e nivelit të financimeve të jashtme dhe buxhetit të brendshëm. Për këtë arsye, fiton edhe më tepër rëndësi sinkronizimi i financimeve të brendshme dhe të jashtme, si edhe bashkëpunimi me donatorët.

Vitet e fundit po i kushtohet rëndësia e duhur krijimit të një arkitekture bashkërendimi të përbashkët dhe efektive për ndihmën e huaj. DEBASKON-i dhe STD-ja, bashkë me një sërë organesh konsultative, synojnë të promovojnë dialogun, bashkërendimin, harmonizimin dhe komplementaritetin e ndërhyrjeve të donatorëve si edhe rakordimin me prioritetet e Qeverisë.

DEBASKON-i ka krijuar tashmë një bazë të dhënash të ndihmës së huaj, e cila përmban mbi 1500 projekte në zbatim dhe të planifikuara, me qëllim që të ofrojë një tablo analitike të aktiviteteve të donatorëve në secilin sektor. Për të përmirësuar bashkërendimin dhe monitorimin në nivel sektori të ndihmës së huaj, janë ngritur 32 Grupe Sektoriale Pune dhe nëngrupe për shumicën e fushave dhe nënfushave. Përmirësime të dukshme janë bërë gjatë vitit 2009 dhe 2010 në lidhje me organizimin dhe takimet periodike të shumicës së GSP-ve.

Në shtator 2010, Vendimi i Këshillit të Ministrave për Administrimin e Financimeve të Huaja shërbeu për të forcuar rolin bashkërendues të DEBASKON-it. DEBASKON-i bashkëdrejton me Ministrinë e Financave negociatat me donatorët në përcaktimin e kushteve të politikave për rastet e huave/kredive, si dhe luan rol kyç në negociatat për programimin e IPA-s, të drejtuara nga Ministria e Integritimit.

Në nëntor 2009, Qeveria dhe komuniteti i donatorëve miratuan *Planin e Veprimit për Harmonizim*, i cili, bazuar në parimet e Deklaratës së Parisit, përcakton detyra të qarta për Qeverinë dhe donatorët për pesë parime të efikasitetit të ndihmës: pronësia, përafrimi, harmonizimi, menaxhimi për rezultate dhe llogaridhënia e ndërsjellë. Këto parime vënë institucionet shqiptare dhe komunitetin e donatorëve para detyrimit që të forcojnë partneritetin e ndërsjellë dhe të zbatojnë nisma ndihme në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim. Rrjedhimisht, agjencitë donatore dhe organet e qeverisjes po forcojnë bashkëpunimin për të rritur impaktin e kontributit të tyre, për të garantuar harmonizim me strategjitë kombëtare të zhvillimit, si dhe për të arritur bashkëpunim të sinkronizuar me donatorët e tjerë.

Miratimi i PVH-së u pasua nga nënshkrimi në maj 2010 i Memorandumit të Mirëkuptimit për Iniciativën “Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës” ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe gjashtë shteteve europiane, duke shënuar kështu një tjetër hap drejt përmirësimit të bashkërendimit dhe rritjes së efikasitetit të dhënies së ndihmës.

Raporti Vjetor i Ndhmës së Huaj 2009-2010 synon të japë një tablo analitike të aktiviteteve donatore në Shqipëri dhe të pasqyrojë mbështetjen e donatorëve sipas sektorëve të ndryshëm. Dokumenti përpiqet të analizojë zbatimin e ndihmës së huaj në nivel sektori dhe ndërsektorial.

*Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
Këshilli i Ministrave*

METODOLOGJIA

Ky raport është përgatitur nga DEBASKON-i si dokument pune i qeverisë.

Si burim parësor të dhënash ka shërbyer baza e të dhënave e donatorëve, e administruar nga DEBASKON-i, ndërsa burimet dytësore përfshijnë bazën e të dhënave të OECD/DAC, Dokumenti i Orientimit të Ndhmës së Huaj (DONH), SKZHI dhe rezultatet e Anketës 2011 për Monitorimin e Deklaratës së Parisit.

Raportimi i sektorëve ndjek ndarjen sektoriale të SKZHI-së, që shërben gjithashtu si bazë për të monitoruar progresin e zbatimit të SKZHI-së,

Informacioni dhe statistikatat e paraqitura në këtë raport bazohen në të dhënat e ofruara nga agjencitë donatore dhe disa institucione shqiptare, përfshirë Ministrinë e Financës dhe ministritë e linjës.

Të dhënat japin një përmbledhje të fondeve të angazhuara dhe të lëvruara nga 1 janari 2000 deri më 31 dhjetor 2010. Prirjet e shkuara të ndihmës së huaj janë analizuar sipas një procesi të zakonshëm pune nga DEBASKON-i, duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësuesit e STD-së. Raporti analizon hollësisht dhe fokusohet tek angazhimet dhe lëvrimet e donatorëve për periudhën 1 Janar 2009 deri në 31 Dhjetor 2010.

Kufizime: DEBASKON-i është i vetëdijshëm që disa të dhëna mund të mungojnë ose të mos jenë plotësisht të sakta. Pasaktësi mund të ketë edhe në pjesën rrefyese për sektorët.

Shifrat e paraqitura në raport mbi lëvrimet e financimeve dypalëshe të periudhës 2000-2010 dhe 2009-2010 mund të ndryshojnë nga raportimet e donatorëve dypalësh për OECD/DAC. Këto ndryshime mund të shpjegohen me kanalizimin e mbështetjes dypalëshe nëpërmjet aktorëve shumëpalësh.


FALENDERIME

Raporti i Progresit për Ndhmën e Huaj 2009-2010 është përgatitur me mbështetjen dhe asistencën e shumë institucioneve shtetërore dhe donatorëve. DEBASKON-i falënderon të gjithë përfaqësuesit e agjencive donatore, Sekretariatit Teknik të Donatorëve dhe institucionet shtetërore për informacionin e nevojshëm që kanë dhënë për aktivitetet e projekteve dhe programeve, si edhe për përgatitjen e raportit.

PRIRJET E PËRGJITHSHME TË NDIHMËS SË HUAJ

Totali i ndihmës së huaj gjatë viteve 2000-2010 ka qenë rreth 3.71 miliard €¹, nga të cilat rreth 2.17 miliard € (rreth 58%) kanë qenë grante dhe 1.54 miliard € në hua (rreth 42%)². Që në vitin 2000, nivelet e ndihmës së huaj kanë qëndruar në kufijtë e 240-405 milion € në vit. Figura 1.1 tregon shpërndarjen e ndihmës së huaj përgjatë kësaj periudhe kohore (2000-2010). Siç tregohet në figurën më poshtë, në 3 vitet e fundit, rritja e huave jokoncesionare (tregtare) ka kompensuar rënien e qëndrueshme të granteve.

Figura 1.1 Totali i ndihmës së huaj, grante dhe hua 2000-2010 (milion €)



Burimi: OECD/DAC për periudhën 2000-2005; baza e të dhënave e donatorëve e DEBASKON-it për 2006-2010. Krahasuar me shumicën e shteteve të rajonit, Shqipëria ka marrë ndihmë të jashtme për frymë në rritje (Tabela 1.1).

Tabela 1.1 Ndhimja e Huaj (€³) për frymë në 2006-2009

Shteti	NZZh neto për frymë (€)				Popullsia (milionë)
	2006	2007	2008	2009	
Shqipëria	81.9	71.3	78.7	81.6	3.2
Bosnjë-Hercegovina	103.4	87.5	83.9	79.3	3.8
Kosova	-	-	-	314.3	1.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	80.3	71.9	68.6	68.2	2
Mali i Zi	122.5	124.3	115.3	87.0	0.6
Serbia	169.6	82.9	90.6	59.8	7.3

Burimi: OECD/DAC (2010) dhe Treguesit e Zhvillimit Botëror (WDI) (2010)⁴

Në vitin 2009, vëllimi i ndihmës së huaj ka arritur në 356 milion € dhe raporti i ndihmës së huaj ndaj produktit të brendshëm bruto (PBB) është vlerësuar të jetë 4.1%. Në vitin 2010 vëllimi i asistencës së huaj arriti në 423 milion € dhe raporti i ndihmës së huaj ndaj produktit të brendshëm bruto (PBB⁵), ka arritur në 4,64%.

1 Kjo shifër përfshin projektet në vazhdim dhe të përfunduara, si edhe angazhimet e donatorëve gjatë 2009-2010

2 Burimi: Statistikat e OECD-së për vitet 2000-2005, baza e të dhënave e donatorëve e DEBASKON-it për 2006-2010.

3 Konvertimi i vlerave nga USD në EUR është bërë me kursin vjetor të këmbimit të OECD-së në zonën Euro (17 shtete).

4 <http://data.worldbank.org/sites/default/files/wdi-final.pdf>; dhe <http://data.worldbank.org/indicator/DT.ODA.ODAT.PC.ZS>

5 Sipas Ministrisë së Financave /Kudri makroekonomik dhe fiskal 2012-2014, PBB në vitin 2009 ishte 8.7 miliard € dhe në 2010 ishte 8.9 miliard €


PËRBËRJA E NDIHMËS SË HUAJ⁶

SIPAS LLOJEVE

Gjatë periudhës 2000-2010, ndihma e huaj është ofruar në formë granti dypalësh, huaje shumëpalëshe, granti shumëpalësh, huaje jokoncesionare dhe huaje dypalëshe (Figura 1.2). Në vitin 2000, pjesa më e madhe e ndihmës së huaj të angazhuar ishin grante që përbënin 68% të totalit të fondeve të angazhuara, ndërsa në vitet që pasuan ky lloj financimi është ulur me 10%. Grantet dypalëshe u pakësuan dy vitet e fundit dhe pritet të pakësohen më tej pasi disa donatorë dypalësh po largohen gradualisht. Shumica e huave janë dhënë nga donatorët shumëpalësh dhe janë të orientuara drejt sektorëve të infrastrukturës, energjisë, shëndetësisë, arsimit dhe reformave sociale.

Rënia e granteve dypalëshe është kompensuar nga rritja e huave jokoncesionare dypalëshe, duke çuar në mbështetje relativisht stabël nga ana e partnerëve dypalësh. Grantet shumëpalëshe dhe huatë koncesionare kanë qenë të ndryshme, por vazhdojnë të shfaqin prirjen e fortë për rritje. Vitet e fundit vihet re rritje e huave koncesionare dhe jokoncesionare nga burime dypalëshe, duke shënuar nivelet më të larta.


Figura 1.2 Grantet dhe Huatë Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2000-2010 (milion €) (Angazhuar dhe lëvruar)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Siç shihet në Figurën 1.3, gjatë periudhës 2009-2010 ndihma e huaj në hua është më e lartë sesa ajo në grante. Pjesa më e madhe e ndihmës së ofruar nga donatorët shumëpalësh është në hua, ndërsa ndihma e dhënë nga donatorët dypalësh vazhdon të dominohet nga grantet.

Figura 1.3 Grantet dhe Huatë Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

6 Të dhënat për këtë seksion janë marrë nga baza e të dhënave e donatorëve, të cilat nuk përpunohen plotësisht me të dhënat e OECD/DAC-it.

Donatorët e Granteve dhe të Huave


Në vitin 2008, për shkak të rritjes së fuqishme ekonomike, Shqipëria ka arritur statusin e vendit me të ardhura të mesme dhe si e tillë nuk përfiton më nga financimet koncesionare me zero interes të IDA-s, por kualifikohet për hua tregtare nga IBRD, duke lëshuar sinjale pozitive për investitorët dhe tregjet financiare për të ardhmen ekonomike të vendit.

BEI dhe BERZh-i vazhdojnë të jenë burimi kryesor i huave jokoncesionare, me një portofol përkatësisht prej rreth 297 milion € dhe 271 milion €, kryesisht në energjetikë, transport, ujësjellës-kanalizime dhe arsim. Banka e Këshillit të Europës (CEB) ka miratuar portofole projektesh me vlerë rreth 120 milion €, të cilat mbështesin shëndetësinë, arsimin, punësimin dhe strehimin social⁷.

Banka Botërore është donatori shumëpalësh kryesor që ka ofruar kryesisht hua jokoncesionare prej rreth 279 milion € që nga viti 2000. Programi i ndihmës i Bankës Botërore synon të kontribuojë në uljen e varfërisë dhe përmirësimin e standardit të jetesës, krijimin e vendeve të reja të punës, përgjegjshmërinë në qeverisje, infrastrukturën dhe shërbimet sociale.

Gjatë periudhës 2000-2010, burimi më i madh i kredive bilaterale ka qenë Gjermania/KfW me 16.3% e huave. Në dhjetë vitet e fundit KfW ka ofruar kredi në vlerë 236 milion €. Mbështetja është përqëndruar kryesisht në: energji, ujësjellës-kanalizime dhe zhvillimin e sektorit privat. Gjatë së njëjtës periudhë, Italia ka qenë donatori i dytë më i madh dypalësh duke siguruar ofrimin e një angazhimi financiar prej rreth 228 milion € (ose 15.5% të totalit të huave). Huatë italiane janë të fokusuara kryesisht në: infrastrukturë, energji dhe zhvillimin e sektorit privat. Protokollin e bashkëpunimit për Zhvillim 2010-12 përfshin 28 milion € në hua për të mbështetur projekte në bujqësi dhe sigurinë ushqimore, zhvillimin e NVM-ve dhe sektorin privat si dhe në transport.

Figura 1.4 Huatë Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2000-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë.


Angazhimet gjatë 2009-2010 tregojnë një rritje të huave dypalëshe. Gjermania është bërë burimi kryesor i huave dypalëshe, duke dhënë 137 milion €, ose 33% të totalit të huave. Më pas vjen një tjetër donator dypalësh, Italia, që gjatë dy viteve ka dhënë 71 milion €, ose 17% të totalit të huave. Bankat/donatorët shumëpalësh vazhdojnë të jenë burim i konsiderueshëm huash jokoncesionare, duke ofruar përkatësisht 53 milion € (BEI), 50 milion € (BERZh), 40 milion € (CEB) dhe 31 milion € (BIZh).

Strategjia e re e Partneritetit me Shqipërisë (CPS) e Bankës Botërore për vitet 2011-2014 parashikon huadhënie mbi bazë politikash prej rreth 71 milion € (100 milion USD) që do të fokusohen në reformat sektoriale të shërbimeve sociale dhe në reforma më të gjera që mbështetin rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë.

Qeveria e konsideron të çmuar ndihmën e dhënë nga këto banka shumëpalëshe, për shkak të aftësisë së tyre për të mbështetur investime afatgjata, si dhe për bashkëpunimin me donatorët dypalësh dhe shumëpalësh, bankat e tjera tregtare dhe sektorin privat.

⁷ Shifrat janë marrë nga baza e të dhënave e donatorëve për periudhën 2000-2010.

Figura 1.5 Huatë Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2009-2010 (milion €)




Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 1% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

Grantet jepen kryesisht nga donatorët dypalësh, por Komisioni Europian (KE) dhe OKB-ja janë dy donatorët shumëpalësh kryesorë që japin të gjithë ndihmën në formë granti (Figura 1.6). KE-ja është ofruesi kryesor i granteve dypalëshe e shumëpalëshe, duke ofruar rreth 471 milion € nëpërmjet asistencës së CARDS dhe IPA gjatë periudhës 2000-2010. Ndihma e KE-së shënjestron prioritetet madhore në adresim të integritetit të Shqipërisë në BE.

Figura 1.6 Grantet Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2000-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011


Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 1% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

Nga donatorët dypalësh, Gjermania është donatori kryesor me një kontribut grantesh me vlerë totale 189 milion € në dekadën e kaluar. Ndihma e Gjermanisë është fokusuar në: ujësjellës-kanalizimet, energjetika dhe zhvillimi ekonomik e social. Në kuadër të dy Protokolleve të fundit Dypalëshe të Bashkëpunimit që mbulojnë periudhën 2008-2011, është ofruar ndihmë me vlerë 168.45 milion €, nga të cilat 18.7% janë në formë grantesh.

SHBA (që jep ndihmë kryesisht përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar [USAID]) është donatori i dytë kryesor me 124 milion € ndihmë në formë grantesh në mbështetje të tranzicionit dhe zhvillimit

afatgjatë të Shqipërisë, përmes zbatimit të programeve si: promovimi i rritjes ekonomike dhe begatisë; qeverisja e drejtë dhe demokratike; investimi në njerëz; arritja e paqes dhe e sigurisë, si dhe reformat anti-korrupsion në administratën publike dhe në fushën e drejtësisë.

Figura 1.7 Grantet Dypalëshe dhe Shumëpalëshe 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 1% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".


Gjatë periudhës 2009-2010, Komisioni European vazhdoi të jetë donatori shumëpalësh kryesor me 179 milion € të ofruara, ose gati 50% të vlerës totale të granteve. IPA 2010 me buxhet 93.6 milion € do të financojë projekte në fusha kyçe si: reforma në polici dhe forcimi i shtetit të së drejtës, forcimi i kapaciteteve administrative, mjedisi dhe siguria ushqimore, infrastruktura, furnizimi me ujë dhe sektori i transportit (rrugët lokale). Në kuadrin e Dokumentit të Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) 2011-2013, janë parashikuar edhe 288.8 milion €, të gjitha në formën e granteve.

Ndër donatorët dypalësh, Italia ka dhënë vlerën më të madhe të granteve gjatë 2009-2010 me 44 milion € (ose 12% të vlerës totale të granteve). Nga 56 projekte aktualisht në zbatim, 45 nisma janë në grante. Protokollin e ri të Bashkëpunimit për Zhvillim 2010-2012 i siguron Shqipërisë grant 3 milion € për asistencë teknike si edhe 20 milion € si marrëveshje borxhi swap për të financuar projekte në arsim, shëndetësi dhe punësim. Ofrues të konsiderueshëm ndihme janë edhe SHBA, Greqia dhe Zvicra që kanë dhënë përkatësisht 32 milion (9%) €, 30 milion (8%) € dhe 17 milion (5%) €.

SIPAS DONATORËVE

Në Shqipëri operojnë 10 donatorë shumëpalësh, (asistenca e të cilëve përbën rreth 49% të ndihmës së huaj) dhe 26 donatorë dypalësh (me rreth 51%). Gjashtë donatorët më të mëdhenj shumëpalësh gjatë periudhës 2000-2010 kanë qenë Komisioni European (grante me vlerë mbi 545 milion €) dhe BEI, BB, BERZh, CEB dhe BIZh (me mbi 1.021 miliard € në formë huaje), që së bashku përbëjnë 42% të ndihmës së huaj. Po në këtë periudhë, pesë donatorët dypalësh kryesorët janë Gjermania (me mbi 347 milion € në grante dhe hua), Italia (me mbi 309 milion € në grante dhe hua), Japonia (me mbi 142 milion € në grante dhe hua), SHBA (me mbi 123 milion € në grante) dhe Holanda (me mbi 84 milion € në grante), që së bashku përbëjnë pak më shumë se 27% të totalit të ndihmës së huaj gjatë 2000-2010.

Figura 1.8 Ndhimja e huaj e angazhuar sipas donatorëve, 2000-2010 (milion €; %)




Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 2% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

Edhe pse ndihma në formë granti ka tendencën të pakësohet dhe disa donatorë dypalësh po tërhiqen nga Shqipëria, gjithsesi ndihma e dhënë nga disa donatorë, si Gjermania, ka shënuar rritje në vitet e fundit.

Figura 1.9 Ndhimja e huaj e lëvruar sipas donatorëve, 2000-2010 (milion €; %)




Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 1% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

Gjatë periudhës 2000-2010, vihet re rritje e konsiderueshme e normës së lëvrimin nga donatorët si dypalësh edhe shumëpalësh, krahasuar me periudhën 2000-2008. Kjo do të thotë se Qeveria ka arritur të përthithë më mirë fondet si rezultat i forcimit të planifikimit dhe kapaciteteve zbatuese në Shqipëri.

Totali i ndihmës së huaj të angazhuar për projektet e reja gjatë periudhës 2009-2010 ka qenë 747 milion €. Mbi 50% e ndihmës totale është angazhuar nga tre donatorë: KE-ja, Gjermania dhe Italia. Donatorët shumëpalësh më të mëdhenj vazhduan të jenë KE-ja me 177 milion € (ose 23.7%), BEI me 54 milion (7.2%), BERZh-i me 50 milion € (6.7%), CEB me 40 milion (5.4%) dhe BIZh-i me 31 milion € (4.2%). Nga donatorët dypalësh, angazhimet më të mëdha janë bërë nga Gjermania me 143 milion € (19.2%), Italia me 87 milion € (11.7%), Greqia me 34 milion € (4.6%) dhe SHBA-ja me 31 milion € (4.1%).

Figura 1.10 Ndhimja e huaj e angazhuar sipas donatorëve, 2009-2010 (milion €; %)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Figura paraqet vetëm donatorët kryesorë. Donatorët me kontribut nën 1% të totalit të ndihmës së huaj, janë përfshirë në grupin "Të tjerë".

SIPAS SEKTORËVE

Mbështetja e akorduar sipas sektorëve ka pasur luhatje të mëdha nga viti në vit pa ndonjë prirje të qartë për periudhën 2000-2010. Bazuar në analizat dhe vlerësimet e kryera, ndihma e huaj është akorduar në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike për zhvillimin e vendit.

Tabela 1.2 Ndhimja e huaj e angazhuar sipas sektorëve, 2000-2010 (milion €)

Sektori i SKZhl	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	%
Demokratizimi dhe shteti i së drejtës	85	61	49	67	64	89	36	41	31	46.9	24.8	16%
Zhvillimi ekonomik	30	32	36	17	11	15	16	23	26	32.3	26.8	7%
Transporti	16	16	26	32	20	16	20	29	75	67.35	173.8	14%
Energjitika	33	51	83	61	94	88	107	107	33	55	81.4	22%
Uji	99	53	22	37	47	53	40	48	10	30.3	58	14%
Zhvillimi social	67	47	37	102	46	46	26	37	25	62	22.5	14%
Të tjera	48	58	72	20	29	43	38	28	42	62	35.7	13%


Shënim (1): në terminologjinë e DAC-it, 'zhvillimi ekonomik' përfshin bujqësinë, industrinë, tregtinë, biznesin/sistemin bankar/financat dhe turizmin.

Shënim (2): Të dhënat sektoriale të DAC-it për 2001 nuk përputhen me të dhënat e DAC-it të analizuar sipas donatorëve. Kjo u zgjidh duke u shpërndarë sektorëve totalin e analizës së donatorëve sipas përqindjes mesatare që zinin në vitin 2000 dhe 2002.

Pjesa më e madhe e mbështetjes në dekadën e fundit, si edhe në dy vitet e fundit, është përqendruar tek transporti dhe energjia, pasi janë prioritetet më të qeverisë. Kjo pasqyrohet edhe nga nivelet më të larta të ndihmës së huaj të akorduar. Vetëm gjatë 2009-2010, sektori i transportit ka përfituar mbi 241 milion € (ose 31% të totalit të ndihmës së huaj të akorduar në këtë periudhë), duke u bërë kështu sektori më i mbështetur këto dy vite. Vihet re që në vitin 2010, ky sektor ka përfituar 173.8 milion €, ose trefishin e mesatares vjetore të 10 viteve të fundit. Edhe energjitika ka përfituar investime në rritje këto dy vitet e fundit, me 136 milion €, dhe mbetet sektori të cilit i është dhënë ndihma më e madhe në dhjetë vitet e fundit (22% e shumës totale). Sektorit të ujit vazhdohet t'i kushtohet vëmendje e veçantë, çka e dëshmon prania e një numri të madh donatorësh aktivë në këtë sektor. Gjatë periudhës 2009-2010, ujësjellës-kanalizimet kanë përfituar një total prej 88 milion €. Demokratizimi dhe shteti i së drejtës është një tjetër sektor me mbështetje të

fuqishme, me 16% të totalit të ndihmës së huaj në këto 10 vitet e fundit. Megjithatë, treguesit konfirmojnë se ndihma e huaj për këtë sektor ka ardhur në rënie në vitin e fundit me 24.8 milion €, krahasuar me mesataren vjetore prej 36 milion € gjatë periudhës 2000-2010. Zhvillimi rural dhe rajonal është zgjeruar shpejt vitet e fundit, çka shpjegon përqendrimin e vëmendjes së mjaft donatorëve në këtë fushë. Zhvillimi ekonomik vazhdon të gëzojë vëmendje të konsiderueshme të donatorëve, pavarësisht rënies së lehtë të shumës totale të angazhuar dy vitet e fundit. Norma e lëvrimit është rritur ndjeshëm për shkak të shkallës së lartë të aktiviteteve në vazhdim.

Figura 1.11 Ndhimja e huaj e angazhuar sipas sektorëve, 2009-2010 (milion €; %)




Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2011

SIPAS STATUSIT

Baza e të dhënave e donatorëve përfshin projekte që janë në vazhdim (1.93 miliard €) apo të planifikuara (0.54 miliard €) dhe kanë fonde të siguruara. Aty përfshihen gjithashtu projektet e përfunduara (1.74 miliard €) dhe disa shënime mbi programimin indikator. Situata në 2000-2010, jepet nga grafiku më poshtë:

Figura 1.12 Angazhimet sipas statusit të projekteve 2000-2010 (%)



Burimi: Baza e të dhënave e Donatorëve 2011

Shënim: Grafiku tregon se rreth 13% e fondeve të angazhuara janë planifikuar nga donatorët për projekte të ardhshme. Kjo shifër e ulët rezultoi pjesërisht nga informacioni i paplotë që është dhënë nga donatorët rreth angazhimeve të tyre të pritshme në vitet e ardhshme.

INVESTIMET PUBLIKE ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Tabela 1.3 tregon nivelet e investimeve me financim të brendshëm në sektorë të ndryshëm, siç janë regjistruar në buxhetin e Shtetit. Transporti, Ujësjellës-Kanalizimet, Arsimi dhe Shëndetësia janë sektorët që kanë përfituar përqindjen më të lartë të investimeve nga projektet me financim të brendshëm.

Tabela 1.3 Investimet publike me financim të brendshëm, sipas sektorit 2009-2011

Sektori	Me financim të brendshëm (milion €)		
	2009	2010	2011
Drejtësia	1.29	2.14	4.06
Çështjet e Brendshme	4.85	7.57	5.28
Arsimi	27.52	31.66	22.17
Shëndetësia	12.24	12.33	21.61
Punësimi	0.45	0.72	1.17
Energjetika	0.27	0.37	0.47
Ujësjellës-Kanalizimet	27.50	36.26	24.83
Transporti	476.96	220.82	184.24
Zhvillimi ekonomik	1.40	0.21	0.98
Bujqësia	9.03	7.41	19.57
Mjedisi	1.87	1.29	3.33
Të tjera	31.75	43.87	58.97
Totali	595.12	364.65	346.68

Shënim (1): Vlera e investimeve me financim të brendshëm janë marrë nga statistikat faktike buxhetore 2009-2010 (MF), ndërsa 2011 është planifikuar.

Shënim (2): Vlera e investimeve me financim të brendshëm për Energjetikën në 2008 nuk përfshin investimet e KESH-it (Korporatës Energjetike), për shkak se buxheti nuk financon investimet e KESH-it.

Burimi: Qeveria e Shqipërisë, Thesari dhe Buxheti 2011 (MF)

Përqendrimi relativisht i lartë i mbështetjes së huaj në sektorët e mësipërm do të vazhdojë edhe për disa vite. Disa sektorë përfitojnë shumë ndihmë të huaj sepse përveç investimeve, kanë nevojë për asistencë teknike të fuqishme. Por, do të ketë një prirje për ngushtimin e diferencave ndërmjet sektorëve. Gjithashtu, huatë gjysmë-tregtare që po u jepen disa sektorëve, kryesisht energjetikës, do të bëhen plotësisht tregtare nisur nga prirjet e shkaktuara nga kalimi i Shqipërisë në vend që nuk mund të përfitojë më nga huatë me interes zero të IDA-s si dhe përdorimi i huave nga bilateralët.

1

DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS

Reforma në Administratën Publike dhe Forcimi i Kapaciteteve

PANORAMA E SEKTORIT

Krijimi i një administrate profesioniste bazuar në merita dhe mosdiskriminim e cila të jetë racionale dhe e aftë të përballojë sfidat e integritit, është vizioni i parashikuar në SKZhI në lidhje me reformën në administratën publike. Opinioni i BE-së në nëntor 2010 nënvizon nevojën për forcimin e mëtejshëm të paanësisë së administratës publike, me qëllim avancimin drejt një shërbimi civil profesional, të pavarur dhe të bazuar në merita.

Strategjia për Reformën në Administratën Publike 2009-2013 shtron themelet për forcimin e mëtejshëm të administratës publike që të përmbushë standardet e integritit europian dhe të priorizojë më mirë asistencën e huaj në këtë fushë. Disa nisma në proces po rishikojnë legjislacionin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore në Shqipëri, bazuar në praktikatat më të mira (SIGMA) që janë të përshtatshme për Shqipërinë. Forcimi i kapaciteteve të DAP-it dhe ITAP-it si edhe krijimi i një sistemi modern për menaxhimin e burimeve njerëzore përbëjnë një nga prioritetet imediate që janë adresuar nga Fondi i Shumëpalësh i Besimit i SPI-së.

Me mbështetjen e Komisionit Europian, është ngritur Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) me qëllim që të forcohet bashkëpunimi në fushat e administratës publike dhe menaxhimit në vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe kapacitetet administrative që kërkon procesi i integritit në BE.


NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Gjatë 2009-2010, mbështetja donatore e angazhuar për këtë sektor ka qenë rreth 7.3 milion €, përfshi 11 projekte, 8 nga të cilat filluan në 2009 dhe 3 në 2010. KE-ja është donatori kryesor duke dhënë 4 milion € (75%), e ndjekur nga Gjermania me 0.62 milion € (11%), Italia me 0.35 milion € (6%), OKB me 0.28 milion € (5%), Suedia me 0.11 milion € (2%) dhe Prezenca e OSBE në Shqipëri me 0.05 milion € (1%).

“Fondi Shumëpalësh i Besimit për Forcimin e Kapaciteteve dhe Mbështetjen e Zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar në Shqipëri” bashkëfinancuar nga shtatë donatorë, KE, Austria, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Suedia, Zvicra dhe Holanda me vlerë totale 5.7 milion € dhe i administruar nga Banka Botërore, është krijuar në vitin 2007 dhe do të përfundojë në shtator 2011. Projekti i fokuson aktivitetet në përmirësimin e kapaciteteve për planifikimin strategjik në nivel qendror, nga i cili përfiton edhe DAP-i dhe ITAP-i.

Komisioni Europian, donatori kryesor në këtë sektor, filloi 3 projekte gjatë kësaj periudhe: *Mbështetje për Reformën në Shërbimin Civil* (1 milion €) që synon të forcojë më tej qeverisjen e sektorit publik duke përmirësuar kapacitetet menaxhuese të DAP-it dhe zbatimin e ligjit të Shërbimit Civil; *Mbështetje për forcimin e kapaciteteve administrative të Shqipërisë për menaxhimin dhe bashkërendimin e procesit të zbatimit të MSA-së* (2 milion €) dhe *Instrumenti për Përgatitjen e Projekteve (PPF)* (1 milion €), që synojnë të forcojnë kapacitetet administrative të Ministrisë së Integritit dhe ministrive të linjës në procesin e integritit europian, përfshirë përgatitjen e projekteve/programeve IPA.

Figura 2.1 Administrata Publike - Angazhimet e Donatorëve 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Edhe donatorë të tjerë si Gjermania, Italia, OKB-ja dhe Suedia kanë dhënë mbështetje për forcimin e kapaciteteve të Qeverisë në zbatimin e integritimit evropian, SPI-së, SKZHI-së, Deklaratës së Parisit dhe trajnimit me Përfaqse me Bazë Programi (PBP). Gjithashtu, Turqia dhe Japonia kanë organizuar trajnime/seminare/takime rreth fushave të ndryshme.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Duke pasur në fokus agjendën e integritimit evropian, Komisioni Evropian dhe Gjermania kanë angazhuar një shumë totale prej 5.5 milion € për projekte që fillojnë nga viti 2011. Suedia angazhoi edhe 1.6 milion € për zbatimin e SPI-së, ndërsa Zvicra 0.8 milion €.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Mbështetje për forcimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare që të përballojnë procesin e integritimit evropian dhe zbatimin e MSA-së në qeverisjen qendrore.
- Mbështetje për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar.
- Mbështetje për zbatimin e Reformës në Administratën Publike dhe krijimi i Universitetit të Administratës Publike.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Grupi Sektorial i Punës për Administratën Publike që kryesohet nga Delegacioni i BE-së dhe ku marrin pjesë donatorë aktivë si Zvicra, Suedia dhe Gjermania, ka diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me ligjin e shërbimit civil si dhe me reflektimin e rekomandimeve të Opinionit të KE-së.

Grupi Mbështetës i SPI-së, që është strukturë e përbashkët qeveri-donatorë, trajton zbatimin e SPI-së dhe çështjet e Fondit të Besimit të SPI-së. Gjatë 2009-2010, Grupi i Mbështetjes i SPI-së organizoi tre takime ku shqyrtoi progresin dhe aktivitetet, si edhe miratoi shtyrjen e Fondit Shumëpalësh të Besimit të SPI-së deri në shtator 2011.

Parlamenti, Zgjedhjet, Gjendja Civile dhe Kartat e Identitetit

PANORAMA E SEKTORIT

Modernizimi i Kuvendit është mbështetur nga donatorët që në vitin 2001. Projekti më i fundit i mbështetjes së parlamentit, i financuar nga Holanda me disa faza dhe i zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri (përfundoi në dhjetor 2010), ndihmoi në rritjen e transparencës dhe efikasitetit të aktivitetëve të parlamentit dhe në transformimin e Kuvendit në një model transparence dhe modernizimi. Biblioteka e Kuvendit është pasuruar me rreth 500 tituj librash të rinj. Janë krijuar ambiente studimi për deputetët dhe stafin e Kuvendit. Ky projekt krijoi edhe një rrjet teknologjie informacioni të cilësisë së lartë, duke bërë të mundur transmetimin *online* të seancave plenare dhe transkriptimin e mbledhjeve dhe procesverbalet e komisioneve të përhershme menjëherë pas zhvillimit të tyre.

Modernizimi i gjendjes civile dhe i sistemit të adresave është i rëndësishëm për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike në sektorë si shëndetësia, tatim-taksat, prona, sigurimet shoqërore, arsimi, shërbimet postare, por edhe për të lehtësuar seancat gjyqësore, zbatimin e vendimeve të gjykatave dhe reagimin ndaj emergjencave. Përgatitjet për regjistrin elektronik të gjendjes civile dhe sistemin e adresave përfunduan në nëntor 2008 dhe hodhën bazat për nxjerrjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Ky sistem *online* mundëson regjistrim të saktë të qytetarëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe kërkimin *online* të adresave. Pasaportat biometrike, si kusht kyç për liberalizimin e regjimit të vizave me Bashkimin Europian, kanë filluar të lëshohen që në maj 2009.


Janë bërë përpjekje për të përmirësuar Kodin Zgjedhur me qëllim adresimin e çështjeve të mbetura në lidhje me zbatimin e legjislacionit bazë dhe mbajtjen e zgjedhjeve në përputhje me angazhimet dhe standardet ndërkombëtare. Si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese dhe Kodit Zgjedhor të miratuar me konsensus në vitin 2008, sistemi zgjedhor shqiptar ndryshoi nga i përzier në sistem proporcional rajonal.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Për këto tri fusha gjatë vitit 2009-2010, Parlamenti ka përfituar mbi 65% të angazhimeve të reja i ndjekur nga Zgjedhjet me 26% dhe Gjendja Civile me 9%.

Kanë qenë të pakta angazhimet e reja për Gjendjen Civile dhe Kartat e Identitetit gjatë 2009-2010, konkretisht 0.6 milion €, ku asistencën kryesore e ka dhënë Komisioni Europian me projektin me vlerë 4 milion € (“Modernizimi i gjendjes civile dhe sistemit të adresave në Shqipëri”, i zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri) dhe Norvegjia që ka dhënë 50 000 € asistencë teknike për krijimin e sistemit unik të adresave dhe vendosjen e tabelave të rrugëve, modernizimin e gjendjes civile dhe përgatitjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Komisioni Europian ka akorduar fonde shtesë (mbi 10 milion €⁸) për Censusin dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Figura 2.2 Parlamenti, Zgjedhjet, Gjendja Civile dhe Kartat e Identitetit Angazhimet dhe lëvrimet në 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

8 Kjo shumë përfaqëson fondet shtesë që nuk janë përfshirë në totalin për këtë sektor, por janë përfshirë në Statistikat.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Përmes projektit “Forcimi i Kuvendit të Shqipërisë” në kuadrin e Programit Kombëtar IPA 2010, KE-ja do ta mbështetë parlamentin me një projekt binjakëzimi me buxhet 1.5 milion € për përafrimin e legjislacionit me acquis dhe përmirësimin e rolit mbikëqyrës.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përmirësimi i rolit të Parlamentit në monitorimin e zbatimit të detyrimeve të MSA-së;
- Krijimi i sistemit elektronik të votimit.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është pika fokale donatore e GSP-së për zgjedhjet dhe gjendjen civile. Grupi mbledhet afër periudhës së zgjedhjeve për të diskutuar rreth kontributeve të donatorëve të ndryshëm në reformën zgjedhore si edhe për shmangien e mbivendosjes së ndihmës.

Media dhe Shoqëria Civile

PANORAMA E SEKTORIT

Qeveria e konsideron median e lirë dhe promovimin e shoqërisë civile si një prioritet madhor. Janë konsoliduar disa nisma dhe ide të propozuara nga shoqëria civile, si për të drejtat e njeriut, median dhe kërkimin shkencor. Megjithatë, shoqëria civile varet nga fondet donatore dhe shihet tendenca e organizatave të shoqërisë civile që të hartojnë projekte sipas objektivave të donatorëve dhe jo sipas prioriteteve dhe nevojave të vendit. GIZ ka mbështetur ngritjen e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Kjo Agjenci po mbështet aktivitetet që synojnë nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile si edhe krijimin e kushteve të favorshme për nismat qytetare. Kuvendi pritet të miratojë një Kartë të Shoqërisë Civile.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009-2010

Projektet e reja të filluara gjatë 2009-2010 në mbështetje të medias dhe shoqërisë civile dhe të financuar nga KE, kanë vlerë totale 4.8 milion € dhe përbëjnë 88% të mbështetjes donatore për këtë sektor; Austria jep 6%, ndërsa OKB, BB, Suedia dhe prezencja e OSBE në Shqipëri së bashku japin 6% e mbetur të angazhimit total. Lëvrimet totale për të gjitha projektet në vazhdim janë 8.5 milion €, nga të cilat 4.2 milion € janë lëvruar për projektet e filluara gjatë 2009-2010.

KE mbështet shoqërinë civile përmes dy nismave: *Instrumenti për Shoqërinë Civile - Nismat Qytetare dhe Forcimi i Kapaciteteve* financuar nga IPA 2009 me buxhet 1.5 milion €, si edhe *Instrumenti European për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) - Skema e Mbështetjes me Bazë Vendi (CBSS 1.2 milion €)*, që synon të forcojë rolin e shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të njeriut dhe reformat demokratike. Me po të njëjtin synim, Banka Botërore u ka akorduar grante organizatave të shoqërisë civile në kuadrin e Programit të Granteve të Vogla që në vitin 2001.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Komisioni European do të vazhdojë mbështetjen përmes programit kombëtar IPA dhe përmes EIDHR/CBSS 2010 dhe 2011 me buxhet total 1.2 milion €. Suedia do të japë 0.8 milion € për forcimin e organizatave të shoqërisë civile që merren me mjedisin.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Mbështetje për rritjen e kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OJF-ve, veçanërisht të atyre jashtë Tiranës.
- Rritja e kapaciteteve monitoruese dhe burimeve teknike të KKRT-së si dhe reforma e mëtejshme në media drejt depolitizimit të saj.

DREJTËSIA DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE NË KËTË SEKTOR

Bashkërendimi i donatorëve për prioritetin strategjik Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme mbështetet nga Konsorciumi Ndërkombëtar (IC), një nismë e kryesuar nga donatorët që në vitin 2000, e cila i ofron asistencë Qeverisë në fushën e zbatimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës. Gjatë periudhës 2009-2010, Konsorciumi ka mbajtur 29 takime sektoriale dhe dy sesione plenare, me fokus çështjet si Reforma Ligjore dhe Reforma e Burgjeve, Drejtësia për të Miturit, Policia e Shtetit, Menaxhimi i Integruar i Kufijve dhe Anti-korrupsioni.

Në kuadrin e zbatimit të nismës së BE-së “Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës”, Delegacioni i BE-së vepron si Donator European Kryesor në sektorët që lidhen me Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, dhe lehtëson dialogun e politikave sektoriale si edhe bashkërendimin e ndihmës ndërmjet donatorëve europianë dhe Qeverisë, veçanërisht në kontekstin e agjendës së para-anëtarësimit në BE të Shqipërisë.

Drejtësia

PANORAMA E SEKTORIT


Reformat e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e donatorëve kanë qenë përcaktuese për zhvillime në mjaft fusha si hartimi i legjislacionit, drejtësia penale, organizimi i drejtësisë, zbatimi i ligjit, planifikimi dhe menaxhimi buxhetor gjyqësor, administrimi i gjykatave dhe menaxhimi i çështjeve. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për reformën gjyqësore mbetet objektivi kryesor. Strategjia ndërsektoriale për Drejtësinë është në fazën përfundimtare dhe pritet të miratohet në gjysmën e parë të vitit 2011, pas konsultimeve të gjera në vitin 2009 dhe 2010 me komunitetin e donatorëve dhe aktorët kryesorë. Sfidë mbetet plotësimi i kuadrit ligjor që do të kërkojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e tij.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Për periudhën 2009-2010, ndihma e huaj për këtë sektor ka qenë rreth 26.2 milion € e ndarë në 12 projekte, nga të cilat rreth 17.4 milion € (ose 67%) janë lëvruar⁹ deri në fund të vitit 2010. Lëvrimi gjatë 2009-2010 për të gjitha projektet në vazhdim është 20.8 milion € (7.8 milion € në 2009 dhe 13 milion € në 2010).

Fondet e akorduara për projektet e reja të filluara që nga janari 2009 u fokusuan në infrastrukturën e burgjeve dhe qendrat e paraburgimit dhe kapin vlerën 16.6 milion €; për reformën ligjore janë akorduar 6.4 milion € dhe për sistemin e gjykatave 3.3 milion €.

Figura 2.3 Angazhimet e reja sipas donatorëve gjatë 2009 - 2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

9 Për asistencën e Komisionit Europian, llogaritja e lëvrimeve është bërë nga fondet e kontraktuara gjatë 2009-2010.

“Forcimin i Sektorit të Drejtësisë në Shqipëri” (JuST) i mbështetur nga USAID, është program pesëvjeçar që filloi në dhjetor 2010 dhe me buxhet 6.16 milion €, i cili synon të rritë transparencën e gjykatave, drejtësinë dhe efikasitetin përmes krijimit të zyrave për informimin e publikut, ndërmjetësimit për çështje të drejtës tregtare dhe familjare, përdorimit më të mirë dhe më efikas të sallave të gjyqeve, edukimit në vazhdim të avokatëve, etj.

Në dhjetor 2010, pas asistencës së mëparshme nga CARDS (EURALIUS I dhe II), KE financoi me buxhet 3.3 milion € projektin “Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, i cili do të ndihmojë Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet gjyqësore që të zhvillojnë një sistem drejtësie të pavarur, të paanshëm, efikas, profesional, transparent dhe modern.

Në kuadrin e programeve IPA 2007-2010, një fond total prej 34.2 milion € do t’u kushtohet ambienteve të paraburgimit për të përmirësuar të drejtat dhe kushtet e jetesës së të ndaluarve, përmes ndërtimit të burgjeve dhe qendrave të reja të paraburgimit në Fier, Elbasan dhe Berat.

Prokuroria e Përgjithshme, përmes Njësive të Përbashkëta Hetimore si pjesë të Prokurorisë së Rrethit Tiranë, po mbështetet nga Qeveria e SHBA-së përmes “Marrëveshjes për Pragun e Sfidës së Mijëvjeçarit në Shqipëri – Faza II”. Prokuroria e Përgjithshme, bashkë me institucionet të tjera që merren me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, po përfitojnë asistencë edhe nga Projekti kundër Korrupsionit në Shqipëri (PACA), si dhe nga Projekti IPA 2009 “Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe hetimit të krimit financiar”.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përmirësimi i kushteve në burgje dhe qendra paraburgimi si edhe i burimeve njerëzore dhe materiale për menaxhimin e burgjeve
- Ndërtimi i qendrave të paraburgimit dhe burgjeve të reja në përputhje me standardet e BE-së, me qëllim që të ulët mbipopullimi
- Modernizimi i gjyqësorit përmes një sistemi të integruar dhe të unifikuar të TIK për të gjitha agjencitë në sistemin e Drejtësisë
- Miratimi i kuadrit ligjor, përfshirë ligjet për Konferencën Gjyqësore Kombëtare, drejtësinë administrative dhe administratën gjyqësore, si edhe miratimi i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile për t’u mundësuar gjyqtarëve më tepër autoritet.

Menaxhimi i Integruar i Kufijve (MIK) dhe Migracioni

PANORAMA E SEKTORIT

Si rrjedhojë e të gjitha reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, më 8 nëntor 2010 Këshilli i Ministrave i BE-së shpalli vendimin për të hequr regjimin e vizave me Shqipërinë që nga mesi i dhjetorit 2010.


Zbatimi i efektshëm i Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) dhe i planit të veprimit në përputhje me “Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në Ballkanin Perëndimor” të KE-së, bëri të mundur që të gjitha pikat e kalimit kufitar nga viti 2009 të jenë të lidhura elektronikisht me anë të sistemit TIMS dhe u pajisën me infrastrukturën përkatëse sipas standardeve të BE-së dhe me Kodin Shengen. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) u krijua në maj 2010 me mbështetjen e projektit KE/PAMECA III. Qëllimi i QNOD-së është të garantojë kontrollin civil në hapësirën detare shqiptare dhe rezultate pozitive në luftën kundër aktiviteteve të paligjshme në këtë hapësirë.

Në vitin 2010, Qeveria miratoi Strategjinë për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer si pjesë e politikës kombëtare të migracionit. Ajo zgjeron masa ri-integruese të Strategjisë Kombëtare të Migracionit me qëllim adresimin e plotë të ri-integrimit.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Totali i fondeve donatore të angazhuara për projektet që kanë filluar nga janari 2009 është 7.54 milion € në grante, me normë lëvrimi 89% (rreth 6.25 milion €). Përveç kësaj, shuma e lëvruar gjatë 2009-2010 për projektet e filluara para vitit 2009 është 5.85 milion €. Donatori kryesor është KE-ja (rreth 54.73 milion € ose 77% të të gjitha angazhimeve), e ndjekur nga Italia (me 0.99 milion €), Greqia (rreth 0.4 milion €) dhe OKB/UNHCR (rreth 0.3 milion €).

Figura 2.4 MIK dhe Migracioni – Angazhimet dhe Lëvrimet (për projektet e filluara nga janari 2009, në milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

MIK dhe Migracioni kanë përfituar nga disa projekte që synojnë përmirësimin e politikave të punësimit duke u fokusuar tek emigrantët e kthyer, si edhe ndërtimin e mjediseve pritëse për shtetasit e ripranuar nga vendet e treta. Projekti i KE/IPA 2009 *Mbështetje për Menaxhimin e Kufirit Blu* me vlerë 4 milion € fokusohet në mbikëqyrjen e kufijve detarë, duke përmirësuar ambientet e QNOD-së dhe duke i siguruar furnizim/mirëmbajtje të mjeteve të lundrimit. Projekti i KE-së “Menaxhimi i Integruar i Kufijve: Përmirësimi i infrastrukturës i disa pikave të kalimit kufitar” financoi me 1.1 milion € ndërtimin e PKK-së së përbashkët Muriqan/Sukobine, e përfunduar në qershor 2009. KE/IPA 2009 ka angazhuar 0.46 milion € për rehabilitimin e PKK-së në Morinë, Kukës, përmes përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme për aktivitetet ndërkuftare.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara luan rol të rëndësishëm me financime të konsiderueshme për këtë sektor përmes projektit “Teknologjia e Informacionit për Zbatimin e Ligjit - TIMS” me vlerë 8.75 milion € dhe projektit “Ngritja e Kapaciteteve për Menaxhimin e Integruar të Kufijve” me vlerë 4.5 milion €. Pjesa prej 1.4 milion € përbën transferimin e pronësisë së mjaft harduerëve të prokuruar nga ICITAP dhe të instaluar në 24 pikat e kalimit kufitar, 12 drejtoritë rajonale të policisë dhe 40 komisariate dhe rajonet. Kjo ndihmoi transformimin e dhënies dhe efektivitetin e operacioneve të Policisë së Shtetit dhe uljen e kostove për taksapaguesit.

PRIORITETET E ARDHSHE

- Mbështetje e përmirësimit të Teknologjisë së Informacionit dhe i aseteve operacionale infrastrukturore në pikat e kalimit kufitar
- Mbështetje për forcimin e kapaciteteve, përmes trajnimeve si për oficerët kufitare edhe ata doganorë, me qëllim optimizimin e përdorimit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe rritjen e kapaciteteve kontrolluese
- Mbështetje për Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), veçanërisht në lidhje me sigurimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe sistemit të mbrojtjes nga moti.

Rendi Publik dhe Krimi i Organizuar

PANORAMA E SEKTORIT

Vitet e fundit, Policia e Shtetit ka shënuar progres të vazhdueshëm në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikëve, duke demonstruar profesionalizëm në rritje. Zbatimi i strategjisë për Policinë e Shtetit 2007-2013 ka përparuar, duke bërë që fusha e Policimit në Komunitet të arrijë progres gjatë 2009-2010 dhe të rritet besimi i komunitetit. Mbetet prioritet për të ardhmen transformimi i policisë nga koncepti tradicional i policisë reaguese ndaj krimit në polici parandaluese e krimit (policim proaktiv). Ngritja e strukturave të reja për hetimin e krimit kompjuterik dhe hetimin e pasurive kriminale ka rezultuar në rritjen e kapaciteteve administrative. Në këtë kontekst, në janar 2010 hyri në fuqi ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (i ashtuquajtur Ligji Antimafia) që pritet të ketë efekte pozitive në hetimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale. Progres është shënuar edhe në forcimin e kapaciteteve juridike dhe institucionale kundër pastrimit të parave.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit dhe plani i saj i veprimit, janë fokusuar në përmirësimin e kapaciteteve të Personelit të Kontrollit Kufitar për të diktuar fëmijët potencialisht të trafikuar, rritjen e bashkëpunimit formal dhe *ad hoc*, rritjen e ndërgjegjësimit për trafikimin e fëmijëve dhe forcimin e institucionalizimit mbarëkombëtar të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve.


Zhvillimet botërore në lidhje me terrorizmin dhe impakti i tij në mjaft sfera të jetës, ka bërë që të hartohet një strategji ndërsektoriale për luftën kundër terrorizmit, që pritet të miratohet brenda 2011-ës, dhe bashkë me planin e veprimit synon të çrrënjosë çdo përpjekje të mundshme për akte terroriste.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009-2010

Donatorët kryesorë që ofruan fonde në këtë sektor gjatë 2009-2010 ishin: KE-ja me 1.8 milionë € përmes CARDS 2006 e IPA 2009; SHBA-ja me 0.7 milionë €; Norvegjia me 0.6 milion € etj. Ky sektor gjithashtu është duke u përkrahur nga donatorë të tjerë të cilët edhe pse ofruan shuma më të vogla të ndihmës kanë qenë shumë aktive në këtë sektor.

Totali i fondeve donatore të angazhuar për projektet që kanë filluar në 2009 dhe 2010 shkon në 3.3 milion €, me normë lëvrimit¹⁰ afërsisht 43% e fondeve. Më tej, rreth 2 milion € janë lëvruar në 2009-2010 për të gjitha projektet që kanë filluar para janarit 2009.

Figura 2.5 Rendi Publik dhe Krimi i Organizuar Angazhimet dhe Lëvrimet sipas donatorëve, 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

10 Për asistencën e Komisionit Europian, llogaritja e lëvrimeve është bërë nga fondet e kontraktuara gjatë 2009-2010.

Nësektorët që kanë përfituar më shumë ndihmë të huaj janë: mbrojtja e dëshmitarëve (1.8 milionë €) dhe lufta kundër trafikimit të personave (1.37 milionë €), të ndjekur nga lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit me një shumë më të vogël.

Policia e Shtetit ka marrë mbështetje të konsiderueshme nga Komisioni Europian përmes fazave të ndryshme të Programit PAMECA. Për më tepër, projekti i IPA 2009 “Forcimi i kapaciteteve operacionale dhe logjistike të Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë” (1 milion €) synon të bëjë të mundur që Drejtësia Penale shqiptare të jetë e aftë t’iu garantojë bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe dëshmitarëve nivelin e duhur të sigurisë. Komponenti i dytë i projektit, “Mbështetje për Infrastrukturën Penitenciare dhe përmirësimin e trajnimit dhe kapaciteteve akomoduese të Qendrës për Formimin Policor” që financohet nga IPA 2010, do të realizojë investimet e planifikuara në Master Plan të nevojshme për pajisjen me logjistikë të plotë të Qendrës për Formimin Policor, si dhe do të jetë faza përfundimtare e ndërhyrjeve në këtë Qendër.

SHBA është donatori dypalësh kryesor me projektin me vlerë 4.9 milion € “Mbështetje kundër krimit të organizuar, përmes Trajnimit të Policisë dhe Reformës Institucionale” që vazhdon për 10 vjet dhe që po ndihmon Policinë e Shtetit që të reformojë dhe të zhvillojë organizimin, trajnimin dhe kapacitetet për menaxhim më efektiv.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Projekti me fonde suedeze për Policimin në Komunitet me angazhim total prej 2.6 milion € pritet të fillojë në 2011. Ky projekt synon të përmirësojë aftësinë e Policisë së Shtetit për të vendosur sigurinë në komunitet, si edhe të rritë partneritetin mes policisë dhe publikut.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale të personelit policor nëpërmjet trajnimit dhe rritjes së etikës në punë
- Përmirësimi i mëtejshëm i standardeve të policimit duke ndjekur qasje të orientuara drejt qytetarit dhe zgjidhjes së problemeve, ashtu si në vendet më të zhvilluara
- Rindërtimi dhe përmirësimi i rajoneve policore në disa qarqe, i pasuar nga sigurimi i bazës së duhur materiale dhe pajisjeve policore
- Kërkohet ndihmë e mëtejshme në të gjitha fushat e aktivitetit të Policisë së Shtetit, për hartimin e akteve nënligjore dhe ligjeve në përputhje me standardet e BE-së; forcimi i institucioneve të ngarkuara me luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar.

Anti-korrupsioni

PANORAMA E SEKTORIT

Në dy vitet e fundit, Shqipëria ka miratuar disa masa dhe ligje anti-korrupsion. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale parashikojnë instrumente kyçe për luftën kundër korrupsionit dhe masa speciale hetimi. Ndryshimet në Kodin Penal sollën dispozita për mitmarrjen në sektorin publik dhe në sektorin privat, si edhe për ndikimin e paligjshëm. Miratimi në tetor 2008 i Strategjisë Kombëtare ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisje Transparente (2008-2013), u pasua nga një plan veprimi që i mundëson Qeverisë të ketë një qasje strategjike dhe të arrijë progres të qëndrueshëm në këtë fushë.


Digjitalizimi dhe modernizimi i qeverisjes konsiderohen instrumentet kryesore për të rritur efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve publike. Që nga viti 2009, Shqipëria është i pari vend ku sistemi i prokurimit elektronik është i detyrueshëm për 100% për të gjitha prokurimet e sektorit publik me vlerë mbi 3 000 €.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Ndihma e huaj në këtë sektor ka qenë e fokusuar në masat anti-korrupsion në tatim-taksa dhe dogana duke forcuar procedurat parandaluese dhe kapacitetet monitoruese për zbatimin e planit të veprimit anti-korrupsion. SHBA mbetet donatori kryesor në këtë sektor, i ndjekur nga KE-ja. Kontributi total është 12.9 milion € në grante, nga të cilat rreth 11.6 milion € (ose 91% e kontributit total) janë lëvruar¹¹ deri në fund të vitit 2010. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve u përket dy projekteve aktualisht në zbatim, të financuar nga SHBA në kuadrin e Programit Pragu i Sfidës së Mijëvjeçarit - FAZA II me mbi 10.75 milion € 10.75 milion, dhe nga KE-ja në kuadrin e projektit të IPA 2008 “Projekti kundër Korrupsionit në Shqipëri” me kontribut total prej 2 milion € si edhe 0.13 milion € shtesë nga Këshilli i Europës.

Programi i USAID-it për Shtetin e së Drejtës në Shqipëri, përmes zbatimit të komponentit 2 “Mbikëqyrja Institucionale dhe Auditit”, është fokusuar në uljen e korrupsionit duke përmirësuar balancimin e kompetencave dhe përgjegjshmërinë në qeverisje.

Figura 2.6 Anti-korrupsioni – Angazhimet dhe lëvrimet (për projektet që kanë filluar nga janari 2009, në milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

PRIORITETET E ARDHSHME

- Plotësimi i legjislacionit anti-korrupsion dhe i organizimit institucional, si dhe përmirësimi i monitorimit, raportimit dhe statistikave anti-korrupsion
- Rezultate solide në hetimin-ndjekjen penale-dënimin e korrupsionit në nivelet e larta dhe heqja e barrierave administrative
- Hartimi i programeve trajnuese për metodat, mjetet dhe teknikat e hetimit administrativ dhe penal, procedurat për hetimin financiar, mashtrimin e korrupsionit
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere kundër korrupsionit

Të drejtat e pronës

PANORAMA E SEKTORIT

Gjatë 2009-2010, Qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të adresuar sfidat në lidhje me regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, legalizimi i ndërtimeve pa leje në zonat urbane dhe peri-urbane, zgjidhja e konflikteve për tokën mes ish-pronarëve dhe përdoruesve të tokës, si dhe përmirësimi i prodhueshmërisë

¹¹ Për asistencën e Komisionit Europian, llogaritja e lëvrimeve është bërë nga fondet e kontraktuara gjatë 2009-2010.

së bujqësisë përmes përdorimit eficient të tokës. Strategjia ndërsektoriale për të Drejtat e Pronësisë dhe plani i veprimit janë hartuar dhe pritet të finalizohen brenda vitit 2011. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), si agjenci kryesore që merret me administrimin e tokës, ka treguar përmirësim në realizimin e detyrave të administrimit të tokës në mënyrë efektive. Fondi i Kompensimit të Pronave, Komiteti dhe agjencia ALUIZNI¹² kanë konsoliduar funksionet e tyre gjatë dy viteve të fundit. Me mbështetjen e asistencës së donatorëve, janë vënë re përmirësime edhe në ofrimin, eficientë dhe transparencën e shërbimeve të ZRPP-së e cila synon të përfundojë pjesën më të madhe të regjistrimeve fillestare të pasurive të paluajtshme deri në fund të vitit 2013. Qeveria vazhdon të mbështetë legalizimin e pronave me legjislacion të ri dhe të rishikuar, siç është edhe Ligji për Planifikimin e Territorit.

NDIHMA E PËRGJITHSHME NË 2009-2010

Totali i mbështetjes donatore gjatë 2009-2010 të dhënë drejtpërdrejtë për këtë sektor, për projekte në vazhdim dhe të përfunduara, arrin 10.4 milion €. Përveç projekteve që fokusohen drejtpërdrejtë në të drejtat e pronës, projekti në zbatim i Bankës Botërore për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës ka një komponent të rëndësishëm *Sigurimi i Zotërimit dhe Regjistrimi i të Drejtës së Pasurisë së Paluajtshme* për të cilën janë angazhuar 12 milion €, konkretisht 7.8 milion € nga Banka Botërore dhe 4.2 milion € nga Suedia. Ky komponent synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve, eficientë dhe transparencën e ZRPP-së.

Në vitin 2009, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri filloi zbatimin e projektit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme përgjatë bregdetit të Jonit. Ky projekt po financohet nga KE përmes CARDS 2006 më vlerë 1.9 milion € (Republika Çeke, Greqia dhe Shtetet e Bashkuara).

Në vitin 2010, USAID filloi projektin 5-vjeçar për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri. Ky projekt do të ndihmojë Qeverinë të forcojë sistemin e gjykatave dhe të japë mbështetje për profesionin e avokatit.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), veçanërisht i zyrave rajonale, për sa i përket sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe logjistikës/infrastrukturës; si edhe vazhdimi i procesit të shëndoshë të regjistrimit duke përdorur metodat e përshtatshme
- Trajnimi i administratës gjyqësore mbi mosmarrëveshjet për të drejtat e pronësisë.

12 Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

2

EKONOMIA E TREGUT

Që nga viti 2000, Shqipëria ka shënuar rritje të qëndrueshme ekonomike me rritje mesatare vjetore mbi 6% dhe papunësia ka ardhur në rënie të vazhdueshme. Industria dhe ndërtimi ishin forcat kryesore të këtyre prirjeve, që u rritën në norma rreth 14.15%. Pas krizës financiare globale, Shqipëria ishte ndër të paktat vende në Europë që ruajti rritjen pozitive dhe stabilitetin ekonomik. Gjatë vitit 2010, ekonomia shqiptare është karakterizuar nga përmirësimi gradual i kërkesës agregate dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik krahasuar me vitin 2009. Rritja reale vjetore e PBB-së është përmirësuar me 3.3% në 2009 dhe 3.8% në 2010¹³. Për sa i përket perspektivës afatmesme dhe afatgjatë të ekonomisë, politika fiskale e qeverisë për periudhën 2012-2014 do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit të financave publike, me synimin për të ruajtur stabilitetin e qëndrueshëm dhe performancën e kënaqshme të ekonomisë, si edhe për ta sjellë mirëqenien ekonomike sa më afër mesatares së BE-së.

Financat Publike

PANORAMA E SEKTORIT

Financat publike janë çështje thelbësore e Strategjisë për Financat Publike 2007. Strategjia fokusohet në forcimin e besueshmërisë së buxhetit përmes Sistemit të Planifikimit të Integruar si edhe në përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit në BE. Planifikimi i shpenzimeve po bazohet në programe, dhe ka filluar përgatitja e programeve mbi bazën e rezultateve.

Politika tatimore aktuale synon të ulë barrën tatimore për bizneset, thjeshtimin e sistemit dhe përmirësimin e administrimit të të ardhurave, pakësimin e ekonomisë informale, rritjen e pajtimit vullnetar, zgjerimin e bazës së tatimpaguesve, forcimin e sistemit tatimor dhe promovimin e sipërmarrjes.


Qeveria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar sistemin e prokurimit publik. Sistemi aktual ka përfitur ndjeshëm nga përmirësimet në kuadrin ligjor dhe rregullator, përmes miratimit të ndryshimeve në ligjin e prokurimit publike dhe VKM-së së 1 janarit 2009 që mandaton përdorimin e platformës së prokurimit publik. Është ngritur Komisioni i Prokurimit Publik që u bë funksional në prill 2010, me qëllim që të garantojë shqyrtim efektiv dhe pa vonesa të ankesave për prokurimet. Në vitin 2010, Qeveria me mbështetjen e donatorëve realizoi një vlerësim të pavarur të sistemit të prokurimeve publike, duke zbatuar metodologjinë e OECD-së. Ky vlerësim tregoi progresin e bërë nga Shqipëria drejt vendosjes së sistemeve të besueshme të prokurimit. Në qershor 2010, Shqipëria u njoh nga Departamenti për Çështjet Sociale dhe Ekonomike i OKB-së (UNDESA) për kontributin e saj në përmirësimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe reagueshmërisë në shërbimin publik.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009-2010

Totali i fondeve të akorduara për sektorin e financave publike në 2009 dhe 2010 është 7.5 milion € të angazhuara për projektet e reja (6 milion € në 2009 dhe 1.5 milion € në 2010). KE-ja vazhdon të jetë donatori kryesor duke dhënë mbështetje shtesë në grante. Figura më poshtë jep totalin e fondeve të akorduara sipas fushave.

¹³ Burimi i të dhënave janë Treguesit Makroekonomikë të INSTAT-it.

Figura 3.1 Totali i angazhimeve për financat publike gjatë 2009-2010 sipas fushave (%)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Kategoria "Të tjera" përfshin mbështetjen nga IPA 2009 për menaxhimin e fondeve të KE-së sipas Sistemit të Zbatimit të Decentralizuar.

Lëvrimi total për të gjitha projektet në vazhdim (përfshi ato që kanë filluar para vitit 2009) gjatë kësaj periudhe dyvjeçare është 11.95 milion €, nga të cilat 76% janë fonde të Bashkimit Europian, 11% të SHBA-së, 9% të Mbretërisë së Bashkuar dhe 4% të Suedisë.

Gjatë 2009-2010, KE-ja ka ndihmuar shumë drejtoritë e tatimeve dhe doganave përmes aktiviteteve të vazhdueshmet financuara nga programet CARDS (8 milion €) dhe projektet e reja të financuara nga IPA 2007 dhe 2008. Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave ka përfituar 2.5 milion € nga IPA 2007 për plotësimin e legjislacionit tatimor dhe përmirësimin e praktikave të punës në përputhje me standardet dhe procedurat e BE-së në fushën e kontrollit të brendshëm, hetimit tatimor dhe rrjeteve TIK. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka përfituar 3.5 milion € nga projekti i IPA 2008 për modernizimin e kontrollit dhe monitorimit të sistemeve doganore bazuar në standardet dhe praktikave të BE-së. Suedia po jep 1.3 milion € për Zyrën e Tatimeve në Tiranë dhe Durrës për të përmirësuar shërbimet që u ofrohen taksapaguesve, standardet e BE-së, auditivi, statistikat tatimore dhe shënimet industriale.

Përmirësimi i përgatitjeve të Shqipërisë për Menaxhimin e Decentralizuar të Komponentëve II, III dhe IV të IPA-s ka qenë gjithashtu në fokusin e financimit të KE-së në dy vitet e fundit. KE-ja po jep asistencë shtesë për Ministrinë e Financave/Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit përmes IPA 2007 (1 milion €) dhe IPA 2009 (1.5 milion €).

Nisma të tjera të vogla janë: auditim i plotë i sistemit të prokurimit qeveritar, i financuar nga Banka Botërore dhe mbështetja e BERZh-it për reformën e prokurimeve publike, me qëllim përgatitjen e legjislacionit dytësor dhe tretësor si edhe mbështetjen e zbatimit praktik të këtij kuadri ligjor.

Në vitin 2011 filluan projekte të reja si: Projekti i zgjerimit të sistemit të thesarit (nga IPA 2008 me 1.5 milion €); Mbështetje për prokurimin publik përmes IPA 2008 (1.5 milion €); Forcimi i operacioneve të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe bashkëpunimit institucional (IPA 2009 me 1.5 milion €); Mbështetje për Bankën e Shqipërisë për përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të bankës me *acquis communautaire* (IPA 2008 me 1 milion €); Projekti i Rritjes së Raportimit Financiar Korporativ (CFREP) i financuar nga fondi shumëpalësh i besimit dhe i administruar nga Banka Botërore, me buxhet 1.25 milion € nga Zvicra.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përgatitjet për Menaxhimin e Decentralizuar të komponentëve III dhe IV të IPA-s
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ tatimor, auditiv tatimor dhe ankimimit
- Modernizimi i Administratës Doganore duke përgatitur Sistemit e Menaxhimit të Integruar të Tarifave (ITMS)
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe operacionale të Drejtorisë së Anti-kontrabandës në luftën kundër kontrabandës për sa i përket mbikëqyrjes së hapësirës detare, si dhe asistencë në fushën e MIK-ut përfshirë monitorimin e substancave radioaktive.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP i Financave Publike ka për pikë fokale Bankën Botërore; ndërsa KE-ja, Gjermania dhe Suedia janë angazhuar si donatorë europianë aktivë në kuadrin e nismës Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës (FTI-DOL).

Zhvillimi i Biznesit

INVESTIMET DIREKTE (ZHVILLIMI EKONOMIK)

PANORAMA E SEKTORIT


Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në zhvillimin e biznesit dhe investimeve. Gjatë viteve të fundit, financimet e brendshme dhe investimet e huaja janë fokusuar në programet për zhvillimin e NVM-ve dhe ristrukturimin e sipërmarrjeve industriale, përmirësimin e klimës së biznesit, promovimin e ekspertëve dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë.

Qeveria ka zbatuar një reformë ambicioze për përmirësimin e klimës së biznesit dhe krijimin e një regjimi rregullator transparent, të parashikueshëm dhe të thjeshtë. Kjo reformë, e mbështetur fuqishëm nga donatorët si USAID dhe kooperacioni teknik zbatues GIZ, ka arritur disa rezultate të rëndësishme siç është krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit. Agjencia për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) konsiderohet si agjenci *one-stop-shop* për të gjithë investitorët. Në shkurt 2011 u miratua programi i ri strategjik për novacionin e teknologjisë së NVM-ve për periudhën 2011-2016, i cili krijon premisat për një politikë proaktive novacioni, asistimin e bizneseve gjatë procesit të novacionit, dhe përmirësimin e kapaciteteve teknologjive të sipërmarrjeve. Ky program strategjik është pjesë tërësore e Strategjisë për Zhvillimin e Bizneseve dhe Investimeve 2007-2013. Në përputhje me këtë strategji, Qeveria krijoi Qendrën e Ndërmjetësimit dhe Inovacionit të Biznesit (BRIC), e mbështetur nga IPA 2007 me 3.4 milion €, që synon rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe krijimin e një mjedisi biznesi të shëndetshëm për investimet dhe punësimin. Për më tepër, vlen të përmendet angazhimi i Kooperacionit Teknik Gjerman në fushën e përshtatjes së ligjit (ekonomik) të BE-së me 1 milion €.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009- 2010

Gjithsej 15 projekte (3 të përfunduar tashmë dhe 12 në vazhdim) kanë filluar nga janari 2009 deri në dhjetor 2010 në zhvillimin ekonomik, me 18 milion € fonde të akorduara. Totali i lëvrimeve donatore për periudhën 2009-2010 ishte 27.53 milion €, pothuaj sa dyfishi i lëvrimit në periudhën 2007-2008 (14.7 milion €). Kjo prirje në rritje pritet të vazhdojë edhe për vitin 2011 dhe 2012 (shiko grafikun më poshtë).


Figura 3.2 Zhvillimi Ekonomik - Lëvrimet 2007-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Mbështetja donatore është përqendruar në reformën e klimës së biznesit dhe forcimin institucional, promovimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve në tregjet e brendshme dhe të huaja, rritjen e aksesit të NVM-ve në burimet financiare me qëllim zgjerimin dhe diversifikimin e aktivitetit tregtar, si dhe mbështetjen për rregullimin dhe promovimin e tregtisë. Nënsektori që ka përfituar shumicën e mbështetjes është ai NVM-ve (48%) i ndjekur nga tregtia (11%) dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) me vetëm 2%, por në rritje krahasuar me vitin 2008). Totali i angazhimeve të donatorëve gjatë 2009-2010 jepet më poshtë:

Figura 3.3 Angazhimet sipas donatorëve në 2009 dhe 2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Projektet më të rëndësishme të filluara gjatë 2009-2010 janë: “Projekti për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Konkurruese” (6.7 milion €) i mbështetur nga qeveria e SHBA-së, synon të promovojë konkurrueshmërinë e NVM-ve shqiptare; kontributi gjerman për të forcuar konkurrueshmërinë e NVM-ve (2.4 milion €); mbështetja e Zvicrës për përmirësimin e standardeve të qeverisjes korporatave (1.7 milion €), tregjeve të sigurimit (3 milion €) dhe Fondi i Investimeve për Tregjet e Reja (SIFEM) prej 2.2 milion €; mbështetja nga IPA 2008 e forcimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe Departamentit të Ndhmës Shtetërore në përafrimin e legjislacionit të BE-së, me 1.5 milion €; asistencë teknike e JICA-s për promovimin e industrisë minerare në Shqipëri në shumën 1 milion €. Edhe pse në shumë më të vogël, OKB-ja po mbështet këtë sektor kryesisht përmes Mbështetjes për Kompaktin Global (GC) të nismës Një OKB dhe përmes Investimeve të Huaja Direkte. Gjithashtu, GIZ po promovon NVM-të krijuese duke nxitur prodhimin novator dhe krijues.

Italia po ashtu po mbështet “Programin për zhvillimin e NVM-ve shqiptare (Linja e Kredisë + Fondi i Garancisë)”, tashmë filluar në vitin 2008, me 29.2 milion € për fazën e parë, dhe 15 milion € të planifikuara për fazën e dytë.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Mbështetja për Fondin e Novacionit me qëllim përmirësimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes mbështetjes financiare për zhvillimin e kapaciteteve dhe realizimin e produkteve të reja
- Zhvillimi i sistemeve TIK duke rritur kapacitetet për të ndihmuar bizneset me novacionin dhe përmirësimin e teknologjive
- Programet e mbështetjes për Inkubacionin e Bizneseve dhe Klasterat Shqiptare, si edhe mbështetja e integruar për novacionin e firmave dhe sipërmarrjeve.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Bashkërendimi në këtë sektor është realizuar nga dy tryeza të rrumbullakëta gjatë 2009-2010 të kryesuara nga METE dhe Italia, me pjesëmarrjen e donatorëve të tjerë si BB, BERZh, SHBA, PNUD, KE, Zvicra dhe Gjermania, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe analizimin e progresit në këtë sektor. Takimi i fundit i GSP-së së NVM-ve prezantoi Strategjinë e re për Novacionin dhe Teknologjinë e Bizneseve.

Në kuadër të FTI Dol, Italia ka marrë rolin udhëheqës të donatorëve evropianë për zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë jo vetëm mbështetje financiare, por në veçanti edhe një angazhim konkret për të mbështetur METE në përcaktimin e strategjive dhe planeve të veprimit, dhe të vlerësojë një mënyrë të koordinuar për të gjithë donatorët në sektorin privat.

Infrastruktura e Cilësisë

(MBROJTJA E KONSUMATORIT, STANDARDET, AKREDITIMI DHE METROLOGJIA)

PANORAMA E SEKTORIT

Strategjia ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2007-2013 e miratuar në vitin 2007, përbën kuadrin kryesor politik për këtë fushë. Gjatë 2009-2010, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional me dy projektligje për mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produkteve joushqimore, të cilat janë në fazën përfundimtare. Progres është arritur në krijimin e një sistemi të informacionit për ankesat e konsumatorëve, ngritjen e një rrjeti kombëtar qendrash për këshillimin e konsumatorëve, organizimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe programeve edukative për mbrojtjen e konsumatorit, mbështetjen financiare për shoqatat e konsumatorëve si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Sistemi i metrologjisë (matjes) është komponenti më i kushtueshëm i Infrastrukturës së Cilësisë. Pavarësisht progresit të arritur deri tani me krijimin e Qendrës Kombëtare të Metrologjisë, përgatitjen e strategjisë kombëtare dhe ligjit të ri për sistemin e metrologjisë, si edhe përmirësimin e standardeve, veçanërisht në fushën e kalibrimit, përpjekje të mëtejshme nevojiten për të arritur standardet e BE-së. Opinioni i Komisionit për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE nënvizoi rëndësinë e përpjekjeve për reformimin e qëndrueshëm të legjislacionit dhe organizimit institucional në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Standardet e metrologjisë dhe kalibrimit janë faktorë kyç për pakësimin e barrierave teknike ndaj tregtisë si edhe për lehtësimin e integritimit të Shqipërisë në tregtinë ndërkombëtare, duke përmirësuar cilësinë e produkteve shqiptare dhe rrjedhimisht kapacitetet eksportuese të vendit tonë.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

KE-ja është donatori kryesor që mbështet këtë sektor, me 6.77 milion € në grante kryesisht për metrologjinë, mbikëqyrjen e tregut dhe standardet, certifikimin dhe akreditimin. Më konkretisht, gjatë vitit 2010 janë dhënë 3 milion € nga IPA 2008 dhe 3.5 milion € nga IPA 2009 për forcimin e kapaciteteve institucionale, ligjore dhe administrative të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Për më tepër, Qeveria italiane financon projektin "Forcimi i institucioneve të kontrollit ushqimor në Shqipëri (2 milion €) ndërsa OKB mbështet Programin e Përbashkët për Ushqyerjen në Shqipëri (2.59 milion €). Banka Botërore ka mbështetur zbatimin e strategjisë kombëtare për metrologjinë me projektin "Reformimi i Mjedisit të Biznesit dhe Forcimi Institucional - BERIS" me buxhet 6.3 milion €.

Totali i lëvrimeve është 5.95 milion €, që përbën një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën 2007-2008 (me vetëm 2.87 milion €).

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

KE-ja planifikon të vazhdojë mbështetjen për mbrojtjen e konsumatorit përmes Projektit të IPA 2010 “Mbështetje për infrastrukturën e sigurisë ushqimore” me vlerë 4 milion € që synon të zgjerojë rrjetin e zyrave dhe laboratorëve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në nivel kombëtar dhe rajonal.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Plotësimi i kuadrit ligjor
- Përmirësimi i infrastrukturës së laboratorëve dhe institucioneve bazë
- Përmirësimi i sistemeve të monitorimit të tregjeve të konsumatorëve
- Krijimi dhe forcimi i strukturës së Farmakovigjilencës
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për konsumatorët dhe bizneset.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për Bujqësinë dhe Ushqimin, Zhvillimin Rural dhe Mbrojtjen e Konsumatorit, mes të tjerash, është fokusuar në përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorit, konsolidimin e sigurisë ushqimore si dhe rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

PANORAMA E SEKTORIT


Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është ndër prioritetet madhore të Qeverisë. Një nga objektivat kryesorë të programit të qeverisë për periudhën 2009-2013 është “Shqipëria digjitale” që nxit qeverisjen efektive dhe zhvillimin e politikave demokratike gjithëpërfshirëse.

Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013 u finalizua në konsultim me aktorët kryesorë dhe u miratua nga Këshilli i Ministrave në 2009. Nisma Shqipëria Digjitale promovon përshtetimin e penetrimit të TIK-ut në Shqipëri dhe kërkon investime infrastrukturore, reforma institucionale, përmirësim legjislativ, forcim kapacitetesh dhe zbatim efektiv të këtyre politikave. Fushat prioritare janë infrastruktura, qeverisja elektronike dhe shërbimet publike, arsimit dhe dijet, biznesi elektronik dhe kuadri ligjor.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009-2010

Institucionet që marrin ndihmë nga asistencë donatore në këtë sektor janë Ministria e Inovacionit dhe TIK-ut, Këshilli i Ministrave, ministrinë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore. Asistencë donatore për këtë sektor (për projektet e reja që kanë filluar nga janari 2009 deri në dhjetor 2010) përfshin 5 projekte (2 të përfunduar, 3 në vazhdim), me angazhim total prej rreth 4.8 milion €. Nga ky angazhim, rreth 1.9 milion € (e barasvlershme me 39%) janë lëvruar¹⁴ deri në fund të vitit 2010. Ndërkohë, totali i ndihmës së lëvruar nga donatorët gjatë vitit 2009 dhe 2010 për të gjitha aktivitetet në vazhdim, është rreth 3 milion €.

Figura 3.4 TIK - Fondet e angazhuara në 2009 - 2010 (€)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shënim: Asistencë e SHBA-së në mbështetje të TIK-ut nuk është përfshirë në tabelë, meqë Programi Korporatë e Sfidës së Mijëvjeçarit është raportuar në sektorin e Anti-korrupsionit.

14 Për asistencën e Komisionit Europian, llogaritja e lëvrimeve është bërë nga fondet e kontraktuara gjatë 2009-2010

KE-ja ka angazhuar 4 milion € përmes IPA 2009 me synim ndërtimin e infrastrukturës së qeverisjes elektronike në përputhje me standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, duke shtruar bazat për ndërfunksionimin ndërmjet sistemeve ekzistuese. Norvegjia ka mbështetur Shoqatën e TIK-ut në Shqipëri (390 000 €) dhe PNUD është fokusuar në futjen e aplikacioneve TIK në nivel vendor dhe me projektimin e “X-Road Albania” (205 000 €).

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Në dhjetor 2010, një marrëveshje financiare huadhënieje prej 40 milion € u nënshkrua me Qeverinë austriake për realizimin e disa projekteve në kuadrin e Qeverisjes Elektronike, të cilët fokusohen në tri fusha kryesore: modernizimin e administrimit tatimor, modernizimin e sistemit shëndetësor në Shqipëri dhe i teknologjisë së tij të informacionit, si dhe modernizimi i Regjistrimit të Pronave.

Edhe OKB do të japë asistencë për përmirësimin e themeleve ligjore dhe teknike të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, dhe krijimin e rrjetit kombëtar me brez të gjerë.

Republika Popullore e Kinës do të japë mbështetje për disa laboratorë të universiteteve shqiptare, duke ofruar pajisje TI dhe trajnim me vlerë totale pothuaj 1 milion €.

Për më tepër, programi për Sigurinë Kibernetike i financuar nga Qeveria e SHBA-së, do të japë një angazhim total prej rreth 102 500 €.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Brezin e Gjerë
- Zhvillimi i një biblioteke funksionale digjitale
- Rritja e numrit të shërbimeve publike online përmes zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës së qeverisjes elektronike dhe forcimit të kapaciteteve institucionale
- Forcimi i prokurimit elektronik dhe zhvillimi i sistemit arsimor elektronik, i strategjisë për shëndetësinë elektronike dhe i mjedisit të biznesit elektronik.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për TIK-un i kryesuar nga PNUD-i dhe Ministria e Inovacionit dhe TIK-ut, synon të analizojë progresin e arritur dhe politikat e reja të miratuara për këtë sektor, si dhe të rekomandojë hapat e mëtejshëm për përgatitjen e një letre politikash për krijimin e rrjetit kombëtar me brez të gjerë në Shqipëri.

Statistikat

PANORAMA E SEKTORIT

Zbatimi i programit kombëtar 5-vjeçar 2007-2011 për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Statistikave është vendimtar për INSTAT-in, pasi rrit transparencën e statistikave kombëtare dhe i sjell më afër kërkesave dhe standardeve të EUROSTAT-it. Programi synon të realizojë tre regjistrime në këto fusha: censusi ekonomik në 2010; censusi i popullsisë në 2011 dhe censusi i bujqësisë në 2012. Censusi i sipërmarrjeve ekonomike jobujqësore është i pari i këtij lloji dhe pritet të përmbillet me një regjistër të besueshëm të bizneseve, duke përmirësuar cilësinë e statistikave ekonomike dhe të llogarive kombëtare. Censusi i njësisë ekonomike bujqësore do t'i mundësojë INSTAT-it të krijojë një regjistër fermash që do të shërbejë për gjenerimin e statistikave bujqësore të besueshme në përputhje me kërkesat e BE-së. Hapa të mëtejshëm janë bërë në përgatitjet për hartimin e programit të radhës 5-vjeçar për statistikat.

Institucioni kryesor përfitues është INSTAT-i, si prodhuesi kryesor i statistikave kombëtare. INSTAT-i është përgjegjës edhe për bashkërendimin e sistemit statistikor shqiptar. Përfituesit e tjerë janë MPCSShB, MSh, MASH dhe ministrinë e tjera përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave statistikore.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010


Totali i angazhimeve donatore për projektet e filluara në 2009 është 15.5 milion €. Totali i lëvrimeve për të gjitha projektet në vazhdim gjatë 2009-2010 është 9.5 milion €, nga të cilat 6.8 milion € janë lëvruar për projektet që kanë filluar gjatë viti 2009.

Përmes Programit IPA 2007 (2.85 milion €) dhe Programit të Bashkëpunimit Statistikor në kuadrin e IPA 2008 me Shumë Përfitues (4 milion € për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë), KE-ja po mbështet Llogaritë Kombëtare, statistikat makroekonomike, statistikat e çmimeve, tregtinë me jashtë, statistikat e bizneseve dhe bujqësisë, statistikat demografike dhe sociale (censusi i popullsisë).

Qeveria e Suedisë po mbështet prej kohësh Shqipërinë që të përmirësojë sistemin statistikor (statistikat e çmimeve, anketa për strukturën e bizneseve, statistikat afatshkurtra), me qëllim harmonizimin e produkteve me ato të EUROSTAT-it. Në vitin 2010, filloi faza e re me 2.4 milion € përfshirë komponentët e rinj si Statistikat Bujqësore, censusi ekonomik 2010 dhe censusi i popullsisë 2011.

Rreth 700,000 € është siguruar për INSTAT, në formën e një kontributi me financim direkt për të mbuluar koston e regjistrimit të ndërmarrjeve ekonomike jo- bujqësore dhe regjistrimit të pronave bujqësore. Ky projekt është një hap përpara në zbatimin e Deklaratës së Parisit dhe Axhendës për Veprim të Accras si dhe përbën një tregues të besimit reciprok dhe një mundësi për rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e ndihmës së donatorëve në mënyrë më efektive nga ana e INSTAT.

Figura 3.5 Statistikat - Angazhimet sipas donatorëve në 2009 dhe 2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011 do të mbështetet nga Programi IPA 2009 me 8 milion € dhe Zvicra me 1 milion € do të mbështetin

Gjatë 2009-2010, aktivitetet e tjera në vazhdim janë: Zvicra mbështet përgatitjen e statistikave demografike dhe sociale në Shqipëri (1.25 milion €); Anketa Demografike dhe për Shëndetin 2008-2009 me financime të USAID, OKB, (UNICEF, UNFPA, OBSH), Zvicra dhe Spanja (1.1 milion €). Agjencitë e OKB-së kanë mbështetur mjaft aktivitete, me qëllim forcimin e menaxhimit të politikave të qeverisë bazuar në evidenca (2.5 milion €) si mbështetja për përgatitjen e censurit, zhvillimi i indikatorëve të lidhur me gjininë dhe Anketa e Përdorimit të Kohës 2010.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Statistikat demografike dhe sociale, Anketat për Fuqinë Punëtore, statistikat makroekonomike, statistikat për biznesin dhe statistikat bujqësore
- Projektimi, zhvillimi dhe zbatimi i Magazinës së të Dhënave të BE-së, si edhe automatizimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga burimet administrative
- Kërkohet asistencë teknike për përgatitjen e një politike sensibilizimi si edhe për zbatimin e disa nismave në fushën e sensibilizimit.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Nën drejtimin e INSTAT-it dhe mbështetjen e fuqishme të Suedisë si donator kryesor i këtij sektori, bashkërendimi i donatorëve është funksional dhe në rritje në kuadrin e IPA-s përmes EUROSTAT-it dhe Delegacionit të BE-së në Tiranë. Situata aktuale është më e përshtatshme për të investuar në Përqasjen me Bazë Programi në statistika. Përgatitja e një plani zhvillimi strategjik bashkë me programin statistikor shumëvjeçar mund të shërbejnë si bazë për PBA-në.

3

INFRASTRUKTURA

Transporti

PANORAMA E SEKTORIT

Sektori i transportit mbetet prioriteti më madhor i qeverisë dhe i donatorëve, çka pasqyrohet nga përfitimi i ndihmës më të madhe krahasuar me sektorët e tjerë gjatë periudhës 2000-2010. Sektori i transportit ndahet në katër nënsektore: rrugët dhe menaxhimi, portet, aviacioni dhe hekurudhat.

Në dekadën e fundit janë bërë investime të mëdha në nënsektorin e rrugëve për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të intensifikuar lidhjet ekonomike ndërmjet zonave të ndryshme të Shqipërisë. Janë realizuar shumë projekte infrastrukturore që kanë kontribuar në përmirësimin dhe rehabilitimin e rrjetit kryesor kombëtar rrugor, rritjen e ndjeshme të trafikut dhe pakësimin e kohës dhe kostove të transportit. Sukses është arritur edhe me harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* dhe legjislacionin ndërkombëtar, ratifikimin e disa konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, miratimin e elementëve kyçë për mirëmbajtjen e rrugëve si Masterplani Kombëtar i Transportit dhe përgatitja e programeve 3-vjeçare të mirëmbajtjes dhe investimeve.

Arritje të tjera gjatë viteve të fundit janë edhe përafrimi i legjislacionit të BE-së, reformat institucionale dhe përmirësimi i infrastrukturës portale. Në nënsektorin e trafikut ajror, zhvillimet përfshijnë pjesëmarrjen e Shqipërisë në tregun ajror europian me të drejta të plota dhe të barabarta, liberalizimi i tregut ajror, përafrimi i procedurave për licencimin e aktiviteteve dhe operatorëve të fluturimit në përputhje me standardet e BE-së, dhe garantimi i mbrojtjes juridike ndërkombëtare, etj. Transporti hekurudhor mbështet nënsektori më pak i zhvilluar, me financime të kufizuara vetëm nga buxheti i shtetit, ndërkohë që ekzistojnë nisma të financuara nga FIBP për të vlerësuar rigjallërimin e rrjetit hekurudhor. Qeveria po shqyrton disa opsione për rigjallërimin dhe rehabilitimin e rrjetit hekurudhor. Në transportin detar, progres është arritur në aspektin ligjor, ristrukturimin administrativ dhe investimet e konsiderueshme për rehabilitimin e të gjithë porteve të dhëna nga KE-ja, Italia, BERZh-i, BIZh,i dhe OFID-i.


NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Ndihma donatore për këtë sektor (për projektet që kanë filluar nga janari 2009) janë 233.5 milion € të dhëna për 21 projekte të reja. Rreth 41 milion € (të barasvlershme me 18%, 19.5 milion € në 2009 dhe 20.6 milion € në 2010) janë lëvruar deri në fund të vitit 2010. Për këto projekte, rreth 91% e fondeve ose 212 milion €, janë dhënë përmes huave, ndërsa 9% ose 20.9 milion € janë dhënë në formë granti. Donatorët kanë mbështetur kryesisht nënsektorin e rrugëve dhe menaxhimit që përfaqëson 92% të totalit të angazhimeve, i ndjekur nga portet me 7% dhe aviacioni e hekurudhat me 1%.

Mbështetje e madhe është dhënë për ndërtimin dhe rindërtimin e segmenteve ose pjesë integrale të Korridorit Lindje-Perëndim, Korridorit Veri-Jug dhe rrugës së Arbrit, përfshi segmentet Shkodër-Hani i Hotit, Korçë-Q. Plloçë, Lushnjë-Fier-Vlorë, Fier-Levan-Tepelenë, F.Krullë-Milot, *By Pass*-i Plepa-Kavajë-Rrogoshinë, Dhërmi-Himarë-Qeparo-Sarandë, Sarandë-Konispol, Lezhë-Shëngjin, etj., si edhe për programe të mëdha investimesh në rrjetin e rrugëve dytësore dhe lokale, sidomos ato turistike. Projekti më i madh i investimeve mbetet

përfundimi i rrugës Durrës-Kukës-Morinë¹⁵. Gjithashtu, ka angazhime konkrete për të filluar projektin e rrugës Tiranë-Elbasan. Qeveria është përqendruar në një program investimesh të konsiderueshme për të përmirësuar rrjetin e rrugëve dytësore dhe lokale, përmes një programi të mbështetur nga BEI, CEB, BERZh, BIZh, Banka Botërore, Germany/KfW, OFID dhe KE me mbi 200 milion €.


Figura 4.1 4.1 Angazhimet dhe lëvrimet për çdo nënsektor gjatë 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Donatorët aktivë që financojnë projektet e reja (që kanë filluar nga janari 2009) në këtë sektor janë BERZh (50 milion €), BEI (50 milion €), CEB (40 milion €), BIZh (25 milion €) dhe KE (20 milion €), të ndjekur nga OFID, Italia dhe Gjermania.

Figura 4.2 Donatorët aktivë në sektorin e transportit gjatë 2009-2010



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

15 Segmenti Milot-Rrëshen, pjesë e rrugës Durrës-Kukës-Morinë, është financuar nga IDA me 5 milion \$, nga IBRD me 20 milion \$ dhe nga OFID me 15 milion \$. Segmenti tjetër Kalimash-Rexhepaj është financuar nga BIZh me 41 milion \$.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Projekti kryesor që pritet të fillojë në 2011 është rruga Tiranë-Elbasan, për të cilën BIZh ka angazhuar 152 milion €, Fondi i Arabisë Saudite me 19 milion €, dhe OFID me 15.4 milion €, ndërkohë që vazhdojnë negociatat me Fondin e Abu Dabit dhe donatorë të tjerë¹⁶.

Programi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale do të vazhdojë të përfitojë nga fondi shumëpalësh: dy hua prej 50 milion € secila janë angazhuar nga BERZh dhe BEI në 2010, ndërkohë që KE, përmes programit IPA 2010, planifikon të japë një grant prej 20 milion €. Donatorët e tjerë po negociojnë me Qeverinë shqiptare për të mbështetur këtë program: Japonia po shqyrton mundësinë e dhënies së një huaje prej rreth 78 milion €, ashtu si BIZh që po peshon mundësinë e dhënies së një huaje prej 27 milion € për këtë program në vitin 2013. Në 23.12.2010 Qeveria Shqiptare dhe Gjermania/KfW kanë firmosur një kredi për Fondin Social të Investimeve IV.

BIZh, në kuadrin e programimit të vet 2010-2013, planifikon të japë mbi 109 milion € për sektorin e transportit, 82 milion € për ndërtimin e rrugës Berat-Tepelenë, dhe 27 milion € për Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe për forcimin e kapaciteteve. BEI po shqyrton mundësinë e financimit të *by pass*-it të Fierit (30 milion €). Italia do të financojë 3 milion € për përgatitjen e studimit të fisibilitetit 2010-2012 për sektorin e transportit. Fondi Saudi për Zhvillim po shqyrton mundësinë e financimit të projektit për ndërtimin *by pass*-it të Durrësit me 8.6 milion sektorin e transportit €.

Banka Botërore, në kuadrin e Strategjisë së re të Partneritetit 2011-2014, planifikon të japë 21 milion € për sektorin e transportit. KE-ja do të vijojë mbështetjen me grante për të përmirësuar infrastrukturën rrugore, me vlerësimin e rrjetit hekurudhor dhe me asistencë teknike për përgatitjen e projekteve.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përmirësimi i rrjeteve të transportit, veçanërisht i pikave lidhëse rajonale dhe integrimi rajonal, si përfundimi i Korridorit Lindje-Perëndim (Korridori 8), i Korridorit Veri-Jug, kryesisht rruga Tiranë-Elbasan dhe i Rrugës së Arbrit
- Forcimi institucional, reformimi i menaxhimit financiar dhe mirëmbajtjes së rrjeteve rrugore
- Investimet në rrjetin e rrugëve dytësore dhe rurale, sidomos i rrugëve turistike.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP-ja për transportin ka mbajtur takime *ad hoc* me agjenci donatore dhe institucione financiare si Banka Botërore (pikë fokale e donatorëve), KE, BERZh, BEI, Italia, Gjermania dhe përfaqësues të Qeverisë.

Energjitika

PANORAMA E SEKTORIT

Sektori energjetik ka përfituar investime të konsiderueshme në këto dy vitet e fundit, të fokusuara në rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe transmetimit. METE ka qenë e angazhuar me zbatimin e mjaft politikave energjetike që synojnë zhvillimin e një sistemi të bazuar në parimet e tregut, i cili të garantojë furnizim të sigurt me energji dhe të përdorë me efikasitet burimet duke shkaktuar ndikim minimal në mjedis. Vazhdojnë përpjekjet për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Energjinë 2010-2030 e cila pritet të miratohet brenda vitit 2011.

Që nga viti 2009, sektori ka treguar përmirësim të dukshëm për sa i përket furnizimit të pandërprerë me energji, pasi ndërprerjet e mëparshme i kanë shkaktuar dëmtime të konsiderueshme ekonomisë. Në këtë


¹⁶ Kursi i këmbimit mesatar 2010 i OECD për zonën Euro (17 vende) është përdorur për të këmbyer USD në Euro: BIZh ka miratuar një kredi prej 222.7 milion USD, Fondi i Arabisë Saudite ka miratuar një kredi prej 25 milion USD, dhe OFID 20.40 milion USD.

periudhë janë ndërtuar 46 hidrocentrale të vegjël që shfrytëzohen nga sektori privat. Nga këto, 32 janë dhënë me marrëveshje koncesionare publik-privat, ndërsa 14 janë 100% në pronësi të sektorit privat. Ka vazhduar ndërtimi i termocentralit të Vlorës i cili në fund të vitit 2009 filloi të furnizojë me energji. Në këto dy vitet e fundit, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ka realizuar mjaft investime infrastrukturore me vlerë 9 milion €, duke kontribuar krahas donatorëve në financimin e ndërtimit të disa linjave të transmetimit 110 kV. Këto nisma kanë dhënë efekte pozitive në përmirësimin e treguesve, si rritja e prodhimit të energjisë (të gjeneruar nga impiantet publike dhe private) dhe ulja e importit neto të energjisë elektrike në raport me kërkesën për energji.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009-2010

Sektori energjetik ka përfituar ndihmë pothuaj 147.6 milion € (55 milion € në 2009 dhe 92.6 milion € në 2010) të dhënë kryesisht në formë huash koncesionare (145.5 milion €, ose 98%). Shumica e ndihmës gjatë 2009-2010 vazhdoi të mbështetë nësektorin e energjisë elektrike me 133.5 milion €, duke u fokusuar në ndërtimin e linjave të brendshme të transmetimit dhe lidhjet me sistemet rajonale. Energjia elektrike pasohet nga energjia e rinovueshme (përfshi masat për efikasitetin e energjisë) e cila ka përfituar 3.9 milion €. Gjermania është donatori kryesor i këtij sektori pasi ka dhënë 62% të ndihmës, i ndjekur nga Italia me 38% dhe BEI me 3%. Lëvrimi kapi shumën 83 milion € në 2009 dhe 35 milion € në 2010.

Figura 4.3 Angazhimet e donatorëve për sektorin energjetik gjatë 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Gjatë 2009-2010 filluan tre projektet reja të mëdha. Projekti më i madh është Programi për ristrukturimin dhe forcimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin e tij në sistemin e Ballkanit (linja 400 kV Elbasan-Tiranë dhe Qendra Dispeçer), i mbështetur nga Italia me 51.5 milion €.

Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) ka filluar dy projekte të orientuar drejt fuqizimit të sistemit të transmetimit: projekti prej 42 milion € për ndërtimin e linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri-Kosovë, dhe projekti prej 49 milion € për përmirësimin e sistemit të transmetimit në jugun e Shqipërisë.

Energjetika është një nga sektorët që kualifikohen për FIBP¹⁷, ku përfshihen edhe Transporti, Mjedisi, Ujësjellës-Kanalizimet dhe Infrastruktura Sociale. Në kuadrin e këtij mekanizmi financues, projektet e mëdha në Energjetikë mbështetën realizimin e studimeve të fisibilitetit dhe projektimin e detajuar për sistemet e shpërndarjes së elektricitetit, me fokus në fuqizimin e linjave të brendshme dhe rajonale të transmetimit.

17 Që në dhjetor 2009, Shqipëria përfiton nga FIBP, një nismë e re dhe novatore financimi që mbështet zgjerimin e BE-së. FIBP grumbullon burimet e granteve (nga KE, IFN-të dhe donatorët dypalësh), me qëllim që të sigurohen hua për financimin e projekteve të mëdha infrastrukturore në Shqipëri.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Totali i fondeve të angazhuara për projektet e planifikuara është 77.6 milion €, nga të cilat 40 milion € do të shkojnë për nënsektorin e energjisë elektrike, 24 milion € për energjinë hidrike dhe 12 milion € për të promovuar efikasitetin e energjisë. BERZH-i dhe KfW janë të angazhuara që të kontribuojnë në Projektin e Përbashkët “Siguria e Hidrocentraleve dhe Digave mbi Kaskadën e lumit Drin dhe Mat”, përkatësisht me 10 milion € dhe 20 milion €, përveç fondeve të akorduara nga Banka Botërore që në vitin 2008 (44.5 milion €) dhe Zvicra me grantin 4.1 milion € për të financuar aktivitetet e asistencës teknike.

Gjermania, përmes KfW do të financojë Projektin për Efikasitetin e Qëndrueshme të Energjisë me 12 milion €, dhe ka shprehur interes për të mbështetur Ndërtimin e Linjës së Transmetimit 400 kV Shqipëri-Maqedoni me fonde totale të akorduara prej 30 milion €. Të dy projektet parashikohet të fillojnë në fillim të vitit 2012.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Rritja e prodhimit, veçanërisht përmes prodhimit të energjisë së rinovueshme nga energjia e erës, diellore dhe burimet ujore. Duhet të ndërmerren projekte pilot për të krijuar bazat për tërheqjen e investimeve të konsiderueshme në të ardhmen
- Krijimi i një kuadri institucional dhe rregullator efektiv
- Përmirësimi i rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes
- Mirëmbajtja e hidrocentraleve dhe siguria e digave përballë rrezikut të përmblytjeve që ka goditur veriun e Shqipërisë këto dy vitet e fundit.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për energjinë, ku Banka Botërore është pika fokale donatore dhe Gjermania/KfW vepron si donator kryesor evropian, ka mbajtur vetëm një mbledhje gjatë vitit 2010. Donatorë të tjerë aktivë janë Kooperacioni Italian, Zyra e Bashkëpunimit Zviceran, BERZH, BEI, USAID, PNUD, etj.

Mjedisi

PANORAMA E SEKTORIT¹⁸

Strategjia ndërsektoriale për Mjedisin e miratuar në fund të vitit 2007, është dokumenti bazë që përvijon politikën e qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në përputhje me të, prioritetet e qeverisë fokusohen në miratimin gradual të standardeve të BE-së, rritjen e investimeve sidomos për mbetjet e ngurta, cilësinë e ajrit, trajtimin e ujërave të zeza, rehabilitimin e vatrave të nxeha, zbatimin dhe sundimin e legjislacionit mjedisor, rritjen e komunikimit dhe ndërgjegjësimit për mjedisin dhe përmirësimi e forcimi i sistemit monitorues të mjedisit. Në maj 2011 u finalizua Plani Operacional për Mjedisin, i cili do të shërbejë si dokument i dobishëm planifikimi për Programin Buxhetor Afatmesëm dhe për donatorët që janë të interesuar të mbështesin sektorin e mjedisit, e sidomos për programet e ardhshme IPA.

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta është një prioritet i lartë dhe një grup ndërministror pune është krijuar për këtë qëllim. Me asistencën e KE-së është përgatitur Strategjia kombëtare për mbetjet e ngurta dhe plani përkatës i veprimit. Këto shërbejnë si bazë për dialog ndërmjet Qeverisë dhe donatorëve për zbatimin e një Përqsajeje me Bazë Programi për nënsektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Suedia, Austria dhe Gjermania (KfW) kanë shprehur interes së fundmi që të mbështesin këtë nënsektor, ndërsa USAID është pjesërisht aktiv në menaxhimin e mbetjeve të ngurta nëpër bashki, përmes mbështetjes për Programin e Qeverisjes Vendore ARD në Shqipëri.

¹⁸ Projektet mjedisore mbivendosen me disa sektorë si infrastruktura, energjetika, emergjencat civile, bujqësia dhe zhvillimi rural. Prandaj, numri i donatorëve të përfshirë dhe kontributet e dhëna për këtë sektor mund të jenë më të larta sesa shifrat e paraqitura në këtë raport.


Banka Botërore, përmes programit për Menaxhimin i Integruar dhe Pastrimin e Zonës Bregdetare po ndihmon zhvillimin e turizmit në bregdetin jugor, duke përmirësuar infrastrukturën mjedisore publike dhe shërbimet e bashkive, duke rehabilituar dhe pakësuar rreziqet renditjes, duke përmirësuar infrastrukturën e komunitetit dhe duke fuqizuar burimet arkitekturore dhe kulturore. BB ka dhënë kontribut të rëndësishëm edhe përmes Zhvillimit të Burimeve Natyrore që synon menaxhimin e qëndrueshëm të bazuar në komunitet të burimeve natyrore, që çon në rritje të prodhimit dhe të të ardhurave nga frenimi i degradimit të tokës, përmirësimi i menaxhimit të ujërave, ruajtja e biodiversitetit dhe forcimi i menaxhimit të sektorit publik.

Mjedisi është një nga pesë shtyllat e Programit Një OKB 2006.2010, ku UNEP është agjencia drejtuese e shtyllës “Zhvillimi i Qëndrueshëm Mjedisor”. Agjencitë e OKB-së (UNOBT, UNEP, UNIDO, PNUD, OBSH) kanë ndërmarrë një sërë nismash në mbështetje të qeverisjes së qëndrueshme mjedisore për probleme globale si ndryshimet klimatike, biodiversiteti, degradimi i tokës, ndotësit persistentë organikë dhe promovimi i zhvillimit të turizmit bazuar në natyrë. Në vitin 2009, MMPAU me mbështetjen e OKB-së dhe të Austrisë, nxori dy raporte kombëtare: ‘Komunikata e Dytë Kombëtare e Shqipërisë për Konventën Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike’, si dhe ‘Dokumenti i Politikave për Financimet e Karbonit’, që vlerësojnë situatën e tanishme të ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

NDIHMA E PËRGJITHSHME NË 2009-2010

Angazhimet donatore për këtë sektor (për projektet që kanë filluar nga janari 2009) janë 16.2 milion € në formë grantesh. Totali i lëvrimit gjatë 2009-2010 për të gjitha projektet në vazhdim është 27 milion (15 milion € në 2009 dhe 12 milion € në 2010). Nënsektori i mbrojtjes së mjedisit ka marrë pjesën më të madhe të mbështetjes me 4.9 milion €, i ndjekur nga mbetjet e ngurta me 2.3 milion €. Peshkimi dhe biodiversiteti janë nënsektorët me performancën më të mirë për sa i përket normave të lëvrimit gjatë 2009-2010.


Figura 4.4 Angazhimet dhe lëvrimet sipas nënsektorëve, 2009-2010



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Gjatë 2009-2010, donatorët kryesorë në këtë sektor janë KE-ja (4 milion €), Gjermania (2 milion €), të ndjekur nga Suedia, OKB-ja, Italia, Republika Çeke, SNV-ja dhe Holanda. Projektet e financuara nga KE-ja dhe Suedia janë performancën më të mirë për sa i përket normës së lëvrimit gjatë periudhës 2009-2010.

Figura 4.5 Donatorët aktivë në sektorin e mjedisit gjatë 2009-2010 (%)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Për këtë sektor janë planifikuar rreth 16.36 milion €. Gjermania/KfW do të mbështetë fazën e dytë të projektit “Krijimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane në qarkun e Korçës “ me 9.8 milion € në formë huash. KE-ja, përmes IPA 2010, planifikon të financojë 4 milion € për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe 1.1 milion € për studimin e fisibilitetit për sheshgrumbullimin (landfillin) rajonal. Përmes Projektit për Menaxhimin e Mbetjeve – Faza II, Suedia do të financojë 1.4 milion € për asistencën teknike për planifikimin e masave për mbetjet e ngurta dhe zbatimin e tyre, si edhe mbështetja e një qarku të caktuar me forcim kapacitetsh, planifikim të zonës së grumbullimit të mbetjeve dhe aspektet financiare. Qeveria shqiptare dhe agjencitë e OKB-së po bashkëpunojnë për formulimin e Programit Një OKB 2012-2016, i cili pritet të përmbajë komponentin e rëndësishëm të mjedisit.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Forcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve për të përmirësuar politikëbërjen dhe zbatimin e ligjit, paralelisht me bashkërendimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional
- Miratimi i mëtejshëm i standardeve të BE-së dhe zbatimi i legjislacionit për mjedisin
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i sheshgrumbullimeve sipas standardeve të BE-së
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të mjedisit
- Investimet për trajtimin e ujërave të përdorur (sidomos në zonat turistike), grumbullimin, riciklimin dhe eliminimin (sheshgrumbullime dhe djegie) e mbetjeve të ngurta, rehabilitimin e tokës së kontaminuar dhe burimeve të ndotjes, përmirësimi teknologjik i industrive në pronësi të shtetit
- Mbështetje për industrinë e peshkimit në Shqipëri që t’u afrohet standardeve të BE-së.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Bashkërendimi në këtë sektor sigurohet nga GSP për mjedisin, ku Holanda ka qenë pikë fokale donatore deri në maj 2010, e zëvendësuar aktualisht nga Suedia. Donatorët e tjerë pjesëmarrës janë Holanda, Banka Botërore, Italia, Delegacioni i BE-së, PNUD-i, Gjermania, Danimarka, Japonia, BERZh-i, Republika Çeke, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Franca, Austria dhe USAID-i.

Në kuadrin e Pistës së Shpejtë mbi Ndarjen e Punës, Suedia vepron si Donator Kryesor i sektorit të mjedisit, ndërsa KE-ja, Austria dhe Italia janë Donatorë Aktivë, ndërkohë që Gjermania vepron si Donator Mbështetës.

GSP për mjedisin ka mbajtur dy takime gjatë vitit 2009 dhe tri gjatë 2010, për të diskutuar rreth ecurisë së legjislacionit mjedisor dhe për të shqyrtuar zhvillimin e projekteve gjatë 2010 dhe përgatitjen e programit operacional për 2011-2013.

Ujësjellës-Kanalizimet

PANORAMA E SEKTORIT


Zhvillimi më i rëndësishëm në këtë sektor gjatë 2009-2010 vazhdoi të jetë konsolidimi i transferimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në varësi të pushtetit vendor. Janë bërë përpjekje për forcimin e reformës së decentralizimit dhe për intensifikimin e komercializimit të sektorit. Janë realizuar disa reforma për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe institucional, për menaxhimin financiar, teknik dhe të kërkesës, politikën e komunikimit dhe marrëdhëniet me publikun, me qëllimin që të përmirësohet infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve dhe të ofrohet një rrjet efektiv shërbimesh ujësjellës-kanalizimesh me standarde të krahasueshme me standardet europiane në zonat urbane dhe rurale. Zonat bregdetare, bashkë me disa zona të rëndësishme urbane dhe rurale, kanë qenë në fokus të investimeve që kanë rezultuar në përmirësimin e disa treguesve pozitivë si cilësia e shërbimeve, shtrirja dhe numri i orëve të shërbimeve, rehabilitimi i rrjetit dhe pakësimi i humbjeve.

Mbështetur financiarisht nga Banka Botërore dhe Gjermania/KfW, Qeveria po përgatit dy dokumente bazë: Strategjinë Kombëtare të Shërbimeve të Ujësjellës-Kanalizimeve 2011-2017 dhe Masterplanin e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve¹⁹. Masterplani do të shërbejë si instrument afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për të vlerësuar nevojat për investime, si dhe për prioritizimin, planifikimin dhe buxhetimin e investimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve për zonat urbane dhe rurale. Gjermania/KfW po finacon një analizë për mundësitë e krijimit të një mekanizmi të përbashkët financimi.

NDIHMA E PËRGJITHSHME NË 2009-2010

Totali i angazhimeve për projektet që kanë filluar nga janari 2009 është 88.3 milion € (30.3 milion € në 2009 dhe 58 milion € në 2010), i financuar nga Komisioni European (përmes IPA 2007 dhe 2009) si donatori kryesor me rreth 48.8 milion €, i ndjekur nga Gjermania me 34 milion € dhe BIZh me 5.9 milion €. Për këto projekte, shumica e lëvruar është gati 27.25 milion € (me normë lëvrimi 31%). Përveç kësaj, gjatë të njëjtës periudhë, lëvrimi për projektet që kanë filluar para vitet 2009 ka qenë 48.6 milion €. Ky sektor mbështetet kryesisht me grante me vlerë 51.42 milion € për projektet në vazhdim dhe të përfunduara; gjithashtu janë edhe 38.6 milion € për angazhimet e planifikuara.

Figura 4.6 Angazhimet kundrejt Lëvrimeve në Ujësjellës-Kanalizime nga donatorët gjatë 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

¹⁹ Strategjinë Kombëtare të Shërbimeve të Ujësjellës-Kanalizimeve 2011-2017 pritet të miratohet në mes të vitit 2011 ndërsa Masterplani i Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve pritet të publikohet në mes të vitit 2011

Përmes programit IPA 2007 dhe 2009, KE-ja do të financojë 47.1 milion € për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza dhe të përdorura në Velipojë-Shkodër, në Kavajë-Golem-Durrës, në Kamzë, në Lezhë-Shëngjin dhe në Vlorë. Që nga dhjetori 2009, sektori ka përfituar asistencë teknike nga FIBP përmes projekteve si Studime Fisibiliteti dhe projektimi i detajuar i Ujësjetës-Kanalizimeve në Kamzë (0.45 milion €), Kavajë dhe Golem (0.45 milion €).

Gjermania/KfW po mbështet Projektin e Infrastrukturës së Bashkive (Faza I) me vlerë 16 milion €, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të ujësjetës-kanalizimeve në katër qytete (Gjirokastrë, Fier, Sarandë dhe Lezhë). Gjermania/KfW po financojnë gjithashtu projektin Korça IV me vlerë prej 15 milion € dhe Programin I dhe II Rural i Furnizimit me Ujë në shumën 10 milion €. Përveç kësaj, Gjermania/KfW është duke financuar projektin e furnizimit me ujë në zonat rurale me shumën 5.8 milion € në kuadër të programit SIF IV. Gjermania/KfW po financojnë edhe projektin e investimeve “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimet në Shqipërinë Qendrore” me shumën prej 6.6 milion € për Beratin dhe Kuçovën dhe 4.6 milion € për Lushnjën. Për më tepër, në bashkëpunim me Zvicrën dhe Austrinë, Gjermania/KfW po financojnë projektin e “Furnizimit me Ujë dhe Mbrojtjen Mjedisore të Liqenit të Shkodrës” (Gjermania/KfW 7.5 milion €, Zvicra 5.72 milion € dhe Austria 1.73 milion €). Gjermania/KfW po planifikon gjithashtu të mbështesë me 10 milion € Programin e Ujësjetës-Kanalizimeve në Pogradec (Faza III). Kontributi i Bashkëpunimit Teknik Gjerman (GIZ) për Reformën e Ujit dhe zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare në vitin 2010 arrin në 1.8 milion €.

BB ka mbështetur hartimin e Strategjisë së re Kombëtare për Ujësjetës-Kanalizimet 2011-2017. Austria dhe Gjermania/GIZ kanë dhënë asistencë teknike për Entin Rregullator të Ujit që të përmbushë mandatin e vet me efektivitet dhe rolin rregullator në këtë sektor.

Zvicra është gjithashtu duke kontribuar në një përdorim efikas të burimeve ujore dhe për mbrojtjen e mjedisit në Shkodër (7.6 milion €) dhe Lezhë (10.5 milion €), kryesisht përmes aktiviteteve të mbështetura në kuadër të Projektit të Infrastrukturës Komunale, i zbatuar nga KfW.

Në shkurt 2011 Qeveria Franceze dha një grant prej 450 mijë € për të financuar studimin mbi aktualizimin e Standardeve Teknike të projektimit, zbatimit dhe rregullave teknike të projekteve në sektorin e Ujësjetës-Kanalizimeve. Ky projekt përmban të gjithë elementët e skemës së furnizimit me ujë si: burimet, trajtimi, shpërndarja e ujit të pijshëm, grumbullimi i ujërave të përdorur dhe trajtimi, impiantet e vogla dhe të mëdha të trajtimit të ujërave të ndotur, përfshi pajisjet, materialet, metodat e zbatimit dhe monitorimit të punës.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

IPA 2010 do të financojë 26 milion € për projektin “Mbështetje për infrastrukturën e ujësjetës-kanalizimeve” që është vazhdim i projekteve në vazhdim të financuara nga IPA 2007 dhe IPA 2009. Në kuadrin e Protokollit të Bashkëpunimit Dypalësh për Zhvillim 2010-2011, Gjermania/KfW ka angazhuar 16 milion € për të financuar një sërë projektesh, përfshi “Masterplanin për sektorin e ujësjetës-kanalizimeve” (2 milion €) dhe “Infrastruktura e Bashkive - Faza II (14 milion €). Në kuadrin e Strategjisë së Partneritetit 2011-2014, Banka Botërore do të akordojë deri në 40 milion € për projektin e Furnizimi me Ujë të Bashkive; BEI ka planifikuar 20 milion € për projektin e Furnizimit me Ujë në qarkun e Durrësit.

Një fushë prioritare do të jetë rrjeti dytësor dhe tretësor për zonën e Durrësit (me kosto rreth 10 milion €), për të cilën KE-ja ka përgatitur studimet paraprake të projektit dhe që mund të përfitoj nga financimi i BEI.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përmirësimi i cilësisë dhe zgjerimi i shtrirjes së shërbimeve të ujësjetës-kanalizimeve
- Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjetës drejt parimeve të kontrollit të kostove dhe rikuperimit të plotë të tyre, si edhe zhvillimi i mëtejshëm i qeverisjes korporative
- Mbështetje për forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e qeverisjes dhe të rregullimit, përfshi fuqizimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit
- Përpjekjet për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me Direktivat e Ujit të BE-së.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për Ujësjetës-Kanalizimet me pikë fokale Austrinë dhe donatorë aktivë si BB, Gjermania (GIZ dhe KfW), Delegacioni i BE-së, Zvicra, Italia, PNUD, BERZh, Franca, Suedia, ka mbajtur dy takime gjatë 2010, ku diskutimet kanë qenë të efektshme dhe janë përqendruar në mekanizmat e zgjidhjes së problemeve, përfshi përgatitjen e dokumenteve strategjike.

4

ZHVILLIMI SOCIAL

Arsimi

PANORAMA E SEKTORIT

Arsimi është prioritet madhor në kuadrin e SKZhI-së 2007-2013. Qeveria është e angazhuar të përmbushë nismën “Arsimim për të Gjithë” deri në vitin 2015 si dhe të ritë financimet për këtë qëllim. Në përgjigje të nevojës për modernizimin e sistemit arsimor, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2008-2013. Aty evidentohen shtatë fusha prioritare, përfshi qeverisjen, rritjen e aksesit në arsimin parauniversitar në të gjitha nivelet, përmirësimi i cilësisë në arsim, rritja e financimeve dhe efikasitetit, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, zhvillimi i arsimit parashkollor dhe përmirësimi i arsimit profesional. Ristrukturimi i MASH-it dhe i tërë sistemit arsimor përmes një skeme të qartë përgjegjësish dhe llogaridhënieje po mbështetet nga Projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim” me financime nga BB, BEI, CEB dhe buxheti i Shtetit dhe po zbatohet që nga tetori 2006.


Projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim” mbështet këto fusha: (i) forcimi i menaxhimit, liderit dhe qeverisjes në sistemin arsimor; (ii) përmirësimi i rezultateve të mësimi; (iii) zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore; dhe (iv) modernizimi i sistemit të arsimit të lartë. Arsimi është i vetmi sektor në Shqipëri ku zbatohet PBS përmes projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”.

Arsimi parashkollor është mbështetur me më pak ndihmë krahasuar me nivelet e tjera arsimore. Modelet kontekstuale të Reggio-Emilia dhe “Step by Step” janë futur me mbështetjen e Fondacionit Soros dhe UNICEF-it. Spanja ka qenë aktive duke mbështetur përmirësimin e arsimit parashkollor dhe kujdesin për fëmijët në periferi të Tiranës. Arsimi profesional i është nënshtruar një reforme të rëndësishme që synon përmirësimin e cilësisë dhe përshtatjen me tregun e punës. Donatorët kryesorë kanë qenë KE-ja, Zvicra, të ndjekur nga Gjermania, Austria dhe Italia. Arsimi parauniversitar ka përfituar pjesën më të madhe të ndihmës donatore. Projektet në këtë nënsektor kanë për qëllim kryesisht ndërtimin dhe rehabilitimin e shkollave dhe laboratorëve mësimorë, si edhe përmirësimin e cilësisë dhe të efikasitetit të sistemit arsimor. Donatorët që mbështesin këtë nënsektor janë CEB (me 26.4 milion €), BEI (12.5 milion €), Banka Botërore (10.25 milion €), që bashkëfinancojnë projektin Cilësi dhe Barazi në Arsim. OKB, Italia, Greqia, Holanda, Turqia dhe Zvicra kanë kontribuar gjatë dy viteve të fundit për reformat në këtë nënsektor.

NDIHMA E PËRGJITHSHME NË 2009-2010

Ndihma donatore për këtë sektor (për projektet e reja që kanë filluar nga janari 2009) është 51 milion € në grante, me 79% të fondeve të lëvruara deri në fund të vitit 2010. Donatorët po japin mbështetje kryesisht për arsimin e lartë me 59% të fondeve totale, i ndjekur nga arsimi profesional me 28% dhe arsimi parauniversitar me 13%. Arsimi i lartë ka shënuar normën më të lartë të lëvrimin, i ndjekur nga arsimi parauniversitar dhe ai profesional.


Figura 5.1 Angazhimet dhe lëvrimet sipas nënsektorëve në 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Donatorët kryesorë në këtë sektor janë KE-ja me 8.5 milion €, Zvicra me 3.1 milion €, Italia me 2.3 milion €, Gjermania me 2.4 milion €, Spanja me 2.2 milion €, Austria me 1.6 milion € dhe Turqia me 0.5 milion €. Gjithashtu, Greqia po jep ndihmë të rëndësishme për sektorin e arsimit, përmes financimit të bursave të studimit.

Figura 5.2 Donatorët aktivë në sektorin e arsimit gjatë 2009-2010 (%)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

CEB me 7.3 milion € do të financojë projektin “Ndërtimi dhe Rehabilitimi i Shkollave të Tiranës - Faza II”; Gjermania me 2 milion € dhe Zvicra me 1.5 milion € do të financojnë sistemin AFP në Shqipëri përmes Programit për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe AFP (Faza II) dhe (ALBVET Faza III). Sektori do të mbështetet me kontribute më të vogla edhe nga KE, Italia, Greqia dhe Turqia.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Forcimi i kapaciteteve menaxhuese me qëllim përmirësimin e qeverisjes në institucionet arsimore të të gjitha niveleve
- Zbatimi i strategjisë së decentralizimit në arsim
- Ngritja e Sistemit të Informimit për Menaxhimin e Arsimit (EMIS) funksional në të gjitha nivelet
- Ndërtimi dhe rehabilitimi i institucioneve arsimore dhe mbështetja e mëtejshme e qendrave AFP.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Që prej vitit 2007, me nismën e Bankës Botërore organizohen mbledhje dy herë në vit për rishikimin e reformave në sektorin e arsimit. Këto mbledhje janë një mekanizëm monitorimi për zbatimin e Projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” për tre financuesit: BB, BEI dhe CEB, por gjithmonë agjenda shkon përtej këtij projekti. GSP që fokusohet në çështjet AFP ka për pikë fokale Zvicrën. GSP për Arsimin dhe Formimin Profesional ka mbajtur dy takime në 2009 dhe tre në 2010, duke qenë një nga GSP-të me performancën më të lartë.

Shëndetësia

PANORAMA E SEKTORIT


Arritjet më të mëdha në sistemin shëndetësor si rezultat e reformave të ndërmarra vitet e fundit janë: ulja e ndjeshme e vdekshmërisë foshnjore, arritja e niveleve më të ulëta të vdekshmërisë së nënave, rritja e jetëgjatësisë mesatare të shqiptarëve, zgjerimi i përdorimit të teknologjive në mjekësi dhe telemjekësi, përmirësimi i kapaciteteve menaxhuese, lufta kundër korrupsionit, forcimi i sistemit shëndetësor përmes rritjes së sektorit privat, i cili në bashkëpunim dhe në partneritet me sektorin publik do të përmirësojë cilësinë e kujdesit shëndetësor. Zhvillimi më i vlefshëm ka qenë vendimi i Qeverisë për të zgjeruar mekanizmin kontraktues të Institutit të Sigurimeve Shëndetësore për të përfshirë thuajse të gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor (joprivat), me qëllim rimbursimin e këtyre operatorëve mbi bazën e performancës në dhënien e shërbimeve shëndetësore. Në vitin 2011 pritet të miratohet një Strategji e re kombëtare për sektorin e Shëndetësisë.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Ndihma donatore për këtë sektor (për projektet e reja që kanë filluar nga janari 2009) ishte 21 milion € dhe rreth 5 milion € (të barasvlershme me 26% janë lëvruar deri në fund të vitit 2010. Lëvrimi total gjatë periudhës 2009-2010 ka qenë 28 milion € (18 milion € në 2009 dhe 10 milion € në 2010) ku përfshihen lëvrimet për të gjitha projektet në vazhdim.

Për projektet e reja që kanë filluar nga janari 2009, 76% janë në formën e granteve dhe 24% në hua. Donatorët po japin mbështetje kryesisht për nënsektorin e kujdesit shëndetësor parësor që zë 51% të angazhimeve totale, i ndjekur nga kujdesi shëndetësor dytësor me 29% dhe shëndeti publik me 29%. Shëndeti publik është nënsektori me performancën më të mirë për sa i përket normës së lëvrimit, me 94% të fondeve të lëvruara deri në fund të vitit 2010, i ndjekur nga kujdesi shëndetësor dytësor me 18% dhe kujdesi shëndetësor parësor me 3%.


Figura 5.3 Angazhimet dhe lëvrimet sipas nënsektorëve gjatë 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Për projektet e reja që kanë filluar nga janari 2009, USAID është donatori kryesor me 6.3 milion €, i ndjekur nga Italia me 5 milion €, Japonia me 4.7 milion €, Spanja me 2.5 milion €, OKB, Greqia, KE dhe Turqia me kontribute më të vogla.

Figura 5.4 Donatorët aktivë në sektorin e shëndetësisë gjatë 2009-2010 (%)



Projekti USAID/PRO Shëndetit që përfundoi në shtator 2009, ofroi bazat për një program të gjerë asistence të shpallur nga Banka Botërore, i cili bëri që Qeveria të miratonte disa instrumente dhe ndërhyrje si: miratimi i ligjit për financimin e shëndetësisë dhe i ligjit për asistencën dhe shërbimet sociale, përgatitja e Paketës Bazë për shërbimet shëndetësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, transformimi i qendrave shtetërore shëndetësore në struktura autonome, krijimi i Sistemit funksional të Informacionit Shëndetësor.

Programi ‘Sistemi i Zhvillimit Profesional’ i mbështetur nga Zvicra, krijoi sistemin e akreditimit për Edukimin Mjekësor në Vazhdim, dhe mundësoi krijimin e sistemit të ri-certifikimit dhe ngritjen e Qendrës Kombëtare për Edukimin në Vazhdim.

Projekti i Bankës Botërore Modernizimi i Sektorit të Shëndetësisë në Shqipëri²⁰ nën zbatim gjatë 2006-2011 dhe buxhet prej 19.1 milion \$ (13.3 milion €), është projekt i rëndësishëm që forcon qeverisjen dhe menaxhimin në spitale, përmirëson kuadrin rregullator dhe piloton reforma në administrimin dhe strukturat qeverisëse të spitaleve të përzgjedhura.

Italia ka mbështetur përfundimin e spitalit “Zonja e Këshillit të Mirë”, “Rehabilitimin e Pesë Poliklinikave” në Tiranë, Gjirokastër, Korçë dhe Peshkopi dhe “Forcimin e Qendrës Kombëtare të Traumave” me 20 milion €. CEB me 16 milion € mbështet Programin e Reformimit të Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” si edhe “Rehabilitimin e Spitalit të Shkodrës – Faza 3”. Edhe Japonia, BIZh dhe OFID po kontribuojnë në rehabilitimin e infrastrukturës shëndetësore.

Austria po jep kontribut konsistent për sektorin e shëndetësisë përmes dy projekteve të rëndësishme: (i) përmirësimi i pajisjeve mjekësore në Spitalin Universitar të Tiranës me 14.6 milion €, dhe (ii) përmirësimi i pajisjeve mjekësore në gjatë spitale rajonale me 6 milion € financim.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

CEB ka planifikuar të financojë një projekt të madh (10 milion €) që mbështet Programin e Reformës së Spitalit Universitar të Tiranës – Faza II; Zvicra (1.1 milion €) do të vazhdojë fazën e dytë të Programit për Forcimin e Sistemit të Zhvillimit Profesional. Projekti prej 17.5 milion € i Bankës Botërore, “Huaja për Politikën e Zhvillimit të Reformës në Sektorin Social” do të miratohet gjatë vitit 2011, me një komponent për përmirësimin e efijencës dhe barazisë në financimin e shëndetësisë.

²⁰ Projekti ‘Modernizimi i Sektorit të Shëndetësisë në Shqipëri’ financohet nga huaja e dhënë nga IDA prej 15.54 milion \$, nga qeveria shqiptare me 2.1 milion \$ dhe Qeveria japoneze me 1.6 milion \$.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përmirësimi i efikasitetit dhe barazisë së shpenzimeve shëndetësore dhe përmirësimi i skemës së financimit
- Informatizimi i shërbimeve spitalore dhe farmaceutike
- Zbatimi i masave për transparencën dhe përgjegjshmërinë, si edhe i programeve kundër korrupsionit.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për Shëndetin, me pikë fokale donatore OBSH-në dhe me donatorë pjesëmarrës si Banka Botërore, Kooperacioni Italian, Delegacioni i BE-së, Republika Çeke, Franca, Suedia, Zyra e Bashkëpunimit Zviceran, USAID, UNICEF dhe UNFPA ka mbajtur takime vetëm në mars, qershor dhe nëntor 2009. Diskutimet janë fokusuar në rigjallërimin e GSP-së për Shëndetësinë, përcaktimin e prioriteteve kyçe për sektorin, përmirësimin e bashkërendimit mes donatorëve dhe rritjen e rolit udhëheqës të ministrisë.

Punësimi dhe Rinia

PANORAMA E SEKTORIT

Strategjia sektoriale për Punësimin 2007-2013 synon stabilizimin e tregut të punës në Shqipëri, integrimin e tij në tregun rajonal të punës, dhe përshtatjen e sistemit të Formimit Profesional sipas nevojave të ekonomisë shqiptare dhe kërkesave të integritit evropian.


Zbatimi i Strategjisë është mbështetur fuqishëm nga Qeveria suedeze, përmes kompjuterizimit të të gjitha zyrave rajonale dhe vendore të punësimit. Mbështetja e vazhdueshme nga Qeveria dhe donatorët (Suedia, Franca, ILO dhe KE CARDS 2006) për forcimin e kapaciteteve dhe trajnimin e specialistëve të zyrave qendrore dhe rajonale, ka rezultuar në përmirësime të konsiderueshme të shërbimeve që ofrojnë këto zyra. Edhe zgjerimi i rrjetit të qendrave publike të formimit profesional ka qenë në fokusin e Qeverisë gjatë këtyre dy viteve të fundit. KE ka mbështetur rindërtimin dhe blerjen e pajisjeve për dy qendra formimi profesional (në Korçë dhe Elbasan). Theksi vihet edhe në punësimin e të rinjve në tregun e punës. Plani kombëtar i Veprimit 2011-2013 është hartuar në bashkëpunim me Programin e Përbashkët për Rininë, Punësimin dhe Migrimin” në kuadrin e programit Një OKB, i cili financohet nga Spanja përmes Fondit të Arritjes së OZhM për Rininë dhe Migrimin dhe zbatohet nga agjencitë e OKB-së (ILO, IOM, PNUD dhe UNICEF). Ky program i përbashkët synon të rritë mundësitë e denja të punës për të rinjtë dhe të menaxhojë migrimin në Shqipëri përmes harmonizimit më të mirë të strategjive kombëtare për rininë, punësimin dhe migrimin. Në fushën e standardeve të punës, në vitin 2010 është miratuar udhërrëfytyrë për eliminimin e punës së fëmijëve si edhe është hartuar ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Gjatë 2009-2010, ndihma donatore për këtë sektor përfshin 3 projekte të reja, me angazhim total 3.11 milion €, nga të cilat 2.38 milioin € (të barasvlershme me 76.5%) janë lëvruar tashme. Gjatë kësaj periudhe, totali i lëvrimit për të gjitha projektet është 4.56 milion €.

Aktivitetet më të rëndësishme janë: kompjuterizimi i zyrave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të financuar nga Qeverisë suedeze me 0.8 milion €; dhe Programi i Përbashkët për Rininë, Punësimin dhe Migrimin, i financuar nga Spanja përmes Fondit të Arritjes së OZhM me 2.26 milion €.

Figura 5.5 Angazhimet sipas donatorëve në 2009 dhe 2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka përfituar 1.6 milion € nga projekti i financuar nga KE “Mbështetje për Zyrat Rajonale të Punësimit” dhe nga kontributi italian (1 milion €) që synon forcimin e shërbimeve të inspektimit dhe punësimit dhe të sistemit të trajnimit. Projekti *Brain Gain* i bashkëfinancuar nga Qeveria dhe PNUD-i po kontribuon në rritjen e angazhimit të Diasporës në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë, përmes stimujve për të kthyer efektet e bjerrjes së trurit.

OKB-ja po mbështet brezin e ri me aktivitete të fokusuara në promovimin e jetesës së shëndetshme dhe në parlamentin rinor, me kontribut total prej 2.74 milion €, ndërsa Austria po promovon krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e të rinjve pa përkrahje (444 262 €).

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Projekti më i rëndësishëm i parashikuar të fillojë në 2012 është “Zhvillimi i Burimeve Njerëzore në Shqipëri”, i financuar nga KE/IPA 2010 (3 milion €), që synon përmirësimin e kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si edhe rritjen e punësimit të fuqisë punëtore shqiptare.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Mbështetje për zbatimin e Planit të Veprimit 2010-2013 për punësimit e të rinjve
- Mbështetje për rritjen e nivelit të formimit profesional në Shqipëri
- Studime kërkimore periodike për aftësitë profesionale në tregun e punës
- Forcimi i shërbimeve që promovojnë integrimin socio-kulturor dhe punësimin e të rinjve
- Informatizimi i plotë i zyrave të punësimit.

Përfshirja Sociale dhe Mbrojtja Sociale


PANORAMA E SEKTORIT

Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Përfshirjen Sociale 2007-2013 dhe Strategjia sektoriale për Mbrojtjen Sociale 2007-2013 janë dy strategjitë e miratuara që orientojnë këtë sektor. Gjithashtu, janë edhe tri strategji nënsektoriale që fokusohen përkatësisht në të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuara dhe përmirësimi i kushteve të jetesës të komunitetit rom.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Asistenca donatore gjatë 2009-2010 ishte 6.44 milion € (nga të cilat 33.8% janë lëvruar) dhe është fokusuar në përfshirjen sociale (rreth 85%). Angazhimet janë rritur nga 2.9 milion € në 2009, në 3.5 milion € në 2010, për shkak të kontributit të Japonisë me 1.8 milion €.

Figura 5.6 Rinia dhe Punësimi – fondet e angazhuara nga donatorët në 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Totali i ndihmës së lëvruar nga donatorët për të gjitha projektet në vazhdim gjatë 2009-2010 ishte 5.17 milion €. Kjo shifër tregon ulje të angazhimit donator gjatë kësaj periudhe krahasuar me nivelin e lëvrimin në 2007-2008 (10.44 milion €). Megjithatë, pritjet rritje e nivelit të lëvrimin vitet në vijim (mbi 10 milion €), për shkak të angazhimit të reja që janë bërë së fundmi.

Aktivitetet më të rëndësishme në vazhdim gjatë 2009-2010 kanë qenë: Projekti për Ofrimin e Shërbimeve Sociale (SSDP) i financuar nga Banka Botërore dhe DFID (16.75 milion €) për të mbështetur përmirësimin e standardit të jetesës të shtresave të varfra dhe pa përkrahje në Shqipëri. Japonia përmes Fondit të Besimit të OKB-së (1.83 milion €) po mbështet komunitetet vendore pa përkrahje (komunitetet egjiptiane dhe rome), me fokus të veçantë në përfshirjen sociale dhe sigurinë njerëzore. Edhe Italia po jep kontribut të rëndësishëm (1.27 milion €) me projektet “Përfshirja Sociale për Familjet në Kombinat” dhe me “Forcimin e shërbimeve sociale dhe edukative për të promovuar zhvillimin social dhe kulturor të fëmijëve, rinisë dhe grave në Tale të Lezhës”. Donatorët e tjerë si Holanda, Austria, Norvegjia, Suedia, SHBA dhe Kanadaja, kanë kontribuar në fushat e përfshirjes sociale të romëve dhe të personave me aftësi të kufizuara, mbrojtja e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut. “Mbrojtja e fëmijëve dhe e familjes – TACT III” është projekt i bashkëfinancuar nga OKB, Austria dhe Norvegjia (3.1 milion €). UNICEF po zbaton projektin “Politika Sociale dhe Dijet”, bashkëfinancim i OKB-së dhe Norvegjisë (1.68 milion €), i cili synon të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të politikave nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve.

PRIORIETET E ARDHSHEME

- Krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm të shërbimeve komunitare, duke u fokusuar në decentralizimin e shërbimeve
- Krijimi i një sistemi të kompjuterizuar për regjistrimin, administrimin dhe monitorimin e asistencës ekonomike që u shpërndahet njerëzve në nevojë
- Rishikimi i Strategjisë për Përfshirjen Sociale dhe harmonizimi i politikave dhe masave të saj me Platformën e BE-së për Përfshirjen Sociale.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për përfshirjen sociale kryesohet nga OKB. Në kontekstin e nismës “Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës”, KE, Austria dhe Zvicra janë donatorë europianë aktivë, ndërsa Italia do të bëhet donatore mbështetëse.

Barazia Gjinore dhe Parandalimi i Dhunës në Familje


PANORAMA E SEKTORIT

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së parë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje 2007-2010 shënoi një hov cilësor në përpjekjet e Qeverisë për të adresuar jo vetëm futjen e dimensionit gjinor në politikat publike, por edhe mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna dhe abuzimi. Në vitin 2010, MPÇSShB mori nismën për të rishikuar strategjinë aktuale, e cila u miratua në qershor 2011. Strategjia e rishikuar Kombëtare të Barazisë Gjinore, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje 2011-2015 prioritetizon sërish drejtimet strategjike duke u fokusuar në 4 fusha: (i) forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale; (ii) balanca gjinore në vendimmarrje; (iii) fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave; dhe (iv) ulja e dhunës mbi baza gjinore dhe e dhunës në familje.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Ndihma donatore për këtë sektor (për projektet që kanë filluar nga janari 2009) është 1.84 milion €. Nga ky angazhim, rreth 1.38 milion € (të barasvlershme me 73%) janë lëvruar deri në fund të 2010. Ndërkohë, totali i ndihmës së lëvruar nga donatorët, ku përfshihen të gjitha projektet në vazhdim gjatë periudhës 2009-2010, është gati 4.64 milion €.

Figura 5.7 Angazhimet e donatorëve për çështjet gjinore në 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Nga projektet që kanë filluar pas vitit 2009, mund të përmendim: mbështetja e dhënë nga Italia për Qendrën e Grave “Luna Nuova” (722 168 €); Projekti “Femrat në Qeverisje” i financuar nga SIDA (451 139 €) dhe i zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri; mbështetja e Norvegjisë për projektin “Të ndryshëm por të barabartë”, si edhe nisma të tjera më të vogla që përfshijnë nxitjen e grave për pjesëmarrjen në politikën, mbështetjen e grave viktime të shfrytëzimit seksual, gjenerimin e të ardhurave, etj.

Mbështetja më e qenësishme vazhdon të jetë Programi i Përbashkët për Barazinë Gjinore, që është kontribut i përbashkët i Fondit të Koherencës²¹ të OKB-së dhe i Hoandës, Austrisë, Norvegjisë dhe Spanjës (3.86 milion €), i cili synon të rritë reagimin e bashkërenduar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare.

21 Janë disa donatorë që kontribuojnë në këtë nismë: Spanja, KE, Austria, Holanda, Norvegjia, Zvicra, Finlanda.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Programi Një OKB 2012-2016 pritet të ketë një komponent të rëndësishëm gjinor pas përvojës pozitive të programit të përbashkët për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Është planifikuar të fillojë në 2011 një tjetër nismë e financuar nga *UN Women* për promovimin e politikave të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor në nivel rajonal (71 758 €).

PRIORITETET E ARDHSHME

- Miratimi i politikave/nismave që garantojnë barazinë gjinore në Shqipërisë, balancimin gjinor në vendimmarrje, fuqizimin ekonomik të grave, dhe uljen e dhunës mbi baza gjinore.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës në Familje është e udhëhequr nga UN Women dhe është takuar katër herë gjatë 2009-2010. Në kontekstin e iniciativës FTI-Dol, Austria, Zvicra dhe Suedia janë donatorët europianë aktive në këtë sektor

5 ZHVILLIMI URBAN, RURAL DHE RAJONAL

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural


PANORAMA E SEKTORIT

Strategjia sektoriale për Bujqësinë dhe Ushqimin 2007-2013 dhe Strategjia ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2007-2013 shërbejnë si bazë për orientimin e aktiviteteve në këtë sektor dhe arritjen e objektivave të programit të Qeverisë, si edhe për përputhjen me orientimet strategjike të politikës së BE-së për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Në vitet e fundit, progres është shënuar me përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë, agro-industrisë dhe pylltarisë, mbrojtjen e mjedisit dhe të ambienteve natyrore, kushtet e jetesës në zonat rurale, promovimin e diversifikimit ekonomik dhe bashkëpunimit në kuadrin e zhvillimit rajonal, përmirësimin e skemave mbështetëse nga buxheti i shtetit për zhvillimin rural.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Angazhimi donator për sektorin në periudhën 2009-2010 është rreth 29.5 milion €, nga të cilat 79% janë dhënë në formë granti dhe 21% në formë huash. Norma totale e lëvrimit është 59% (rreth 17.5 milion €). Donatorët kryesorë janë KE, OKB, Italia, Danimarka, Zvicra, etj. (shiko grafikun më poshtë për angazhimet dhe lëvrimet përkatëse).

Figura 6.1 Angazhimet për projektet e filluara në 2009 dhe 2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Projektet që kanë filluar në 2009-2010 janë fokusuar në: (i) prodhimin, agro-përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, me rreth 8.2 milion €; (ii) blegtoaria me 7.3 milion €, (iii) siguria ushqimore²² me 2 milion € angazhim total; (iv) vaditja dhe kullimi me rreth 0.1 milion €, dhe (v) zhvillimi rural me 11.8 milion €.

Spanja ka financuar një nga projektet më të mëdha që mbështet agro-biznesin dhe agro-përpunimin me një fond mikro-kredish prej 21 milion €, që u ka mundësuar fermerëve shqiptarë të përfitojnë nga një skemë huamarrjeje me interesa të ulëta; Projekti i Kuvajtit për Rehabilitimin e Vaditjes dhe Kullimit (9.9 milion €) mbështet rehabilitimin e rrjeteve të vaditjes dhe kullimit; programi pesëvjeçar i USAID për përmirësimin e Konkurrueshmërisë së Bujqësisë Shqiptare (6.8 milion €) mbështet rritjen e qëndrueshme të sektorit bujqësor të Shqipërisë dhe rritjen e të ardhurave të familjeve rurale, duke zhvilluar dhe duke forcuar aftësitë konkurruese të prodhuesve të produkteve bujqësore me vlerë të lartë.

Ndër projektet e nisura në 2009-2010 përmendim: mbështetja nga KE/IPA 2008 për MBUMK për zbatimin e strategjisë së zhvillimit rural (2 milion €) dhe përmirësimin e mbrojtjes publike nga sëmundjet zoonotike (5.7 milion €). Programi i IFAD-it nga Mali në Treg (6.3 milion €) po mbështet fermerët që të përmirësojnë standardet e prodhimit dhe përpunimit. Programi për mbështetjen e Qendrës së Kontrollit të Cilësisë së Produkteve Bujqësore (2 milion €) i financuar nga Italia, fokusohet në zhvillimin e sistemit të sigurisë ushqimore në Shqipëri. Projekti për zhvillimin e integruar rural të Malësisë së Madhe (1.8 milion €) synon të përmirësojë kushtet e jetesës së popullsisë së komunave të Kelmendit dhe Shkrelit. Programi i përbashkët për verilindjen e Shqipërisë (2009-2013) i financuar nga Danimarka (4 milion €) dhe SNV (1 milion €), synon të arrijë zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit dhe rritjen e të ardhurave.

Kooperacioni Gjerman për Zhvillim mbështet shumë projekte rajonale, duke përfshirë ndër të tjera Shqipërinë. Përmes Fondeve të Hapura Rajonale për reformën ligjore, shërbimet komunale, tregtia e jashtme dhe efikasiteti i energjisë, institucionet shqiptare marrin pjesë në projekte me një vlerë prej 7 milion €.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Mbështetja e planifikuar donatore përfshin angazhime nga KE, BB, GiZ dhe Suedia. KE përmes IPA 2011 planifikon të financojë një projekt 10 milion € në mbështetje të Zhvillimit të Qëndrueshëm Bujqësor dhe Rural si edhe të përgatitjeve për masat IPARD. Strategjia e Partneritetit 2011-2014 e Bankës Botërore parashikon një projekt për Burimet Ujore dhe Vaditjen që do të bashkëfinancohet nga Suedia (Sida), i cili do të integrojë dhe do të forcojë menaxhimin e burimeve njerëzore, kuadrin institucional dhe rregullator, si edhe zbatimin e masave për rehabilitimin e sistemeve të vaditjes dhe kullimit, digave, etj.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Përmirësimi i menaxhimit të tokës; përmirësimi i tregtimit të produkteve bujqësore; krijimi i sistemit të informacionit të tokës bujqësore
- Përmirësimi i infrastrukturës mbrojtëse për tokën bujqësore dhe zonat e populluara për të parandaluar përmytjet nga lumenjtë dhe deti
- Plotësimi i dokumentacionit për regjistrin e pronave, përgatitja e librave dhe hartave të tokës, si dhe digjitalizimi i regjistrit të Tokës Bujqësore
- Investime për grumbullimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore; krijimi i një fondi garancie për kreditë rurale.

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

GSP për Bujqësinë dhe Ushqimin, Zhvillimin Rural dhe Mbrojtjen e Konsumatorit kryesohet nga Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GIZ) me pjesëmarrjen e donatorëve si KE, Banka Botërore dhe Italia. Ky GSP mbajti dy takime gjatë vitit 2010, ku u diskutua ecuria e sektorit, hartimi i MIPD 2011-2013 dhe futja e përqasjeve me bazë sektoriale.

²² Edhe siguria ushqimore është diskutuar në kuadrin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut; megjithatë, meqë është institucionalisht e lidhur me Ministrinë e Bujqësisë, është trajtuar në këtë seksion.

Planifikimi Hapësinor dhe Strehimi

PANORAMA E SEKTORIT


Në vitet e fundit, vëmendja është përqendruar në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për planifikimin territorial. Ligji i ri për Planifikimin e Territorit i miratuar në vitin 2009, synon vendosjen e një sistemi moden kontrolli për zhvillimin dhe planifikimin me orientim nga tregu, i cili të lehtësojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në Shqipëri. Ligji u pasua nga krijimi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si autoriteti përgjegjës për harmonizimin e politikave të pushtetit qendror dhe vendor për planifikimin hapësinor. Arritje e rëndësishme ishte edhe krijimi i Regjistrit Kombëtar të Planifikimit për lejet e zhvillimit dhe ndërtimit, duke kufizuar mundësitë për korrupsion në sektorin e ndërtimit.

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Projektet më të rëndësishme që kanë qenë në vazhdim gjatë 2009-2010 janë: Projekti i BB-së për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës me buxhet 6.5 milion € të akorduara enkas për planifikimin hapësinor; “Projekti i Strehimit” i mbështetur nga CEB me 15 milion € që synon ofrimin e 1000 shtëpive me kosto të ulët për familjet në nevojë në qendrat e mëdha urbane të Shqipërisë; Italia me tre projekte (me total 8 milion €) po ndërton infrastrukturën bazë në periferitë urbane të Tiranës dhe Vlorës; Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit II ka mbështetur krijimin e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit.

Një tjetër projekt që filloi në 2009-2010 është “Nxitja e partneriteteve për qytetete të barabarta - Forcim kapacitetesh për planifikim dhe zhvillim hapësinor të qëndrueshëm dhe të barabartë”, i financuar nga Holanda me 0.4 milion €.

Figura 6.2 Angazhimet dhe lëvrimet e donatorëve në 2000-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

PRIORITETET E ARDHSHME

- Mbështetje për objektivin e qeverisë për t’iu siguruar shtëpi me kosto të ulët rreth 12 mijë familjeve deri në vitin 2014
- Mbështetje për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit në misionin e saj për të bashkërenduar autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit hapësinor, në linjë me normat dhe parimet evropiane
- Miratimi dhe zbatimi efektiv i Akteve Normave të Planifikimit të Territorit
- Krijimi dhe përdorimi efektiv i Regjistrit të Planifikimit të Territorit si rrjeti i integruar i të gjitha bazave të të dhënave të dcentralizuara dhe i institucioneve qendrore dhe vendore të planifikimit hapësinor.

Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi


PANORAMA E SEKTORIT

Prioritetet kyçe të politikave të Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit janë orientuar drejt promovimit dhe konsolidimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ruajtjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës dhe promovimit të turizmit shpirtëror. Është përmirësuar kuadri ligjor dhe strategjik me ndryshimet në ligjin ekzistues për trashëgiminë kulturore dhe me Strategjinë sektoriale për Turizmin 2007-2011. Hap i rëndësishëm ka qenë miratimi i Planit të Integruar për Zhvillimin e Bregdetit Jugor në vitin 2009 me mbështetjen e Bankës Botërore. Një tjetër arritje e rëndësishme ishte hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Marketingut Kulturor me mbështetjen e Spanjës dhe Programit të OKB-së për Kulturën dhe Trashëgiminë për Zhvillim Social dhe Ekonomik (CHSED), që synon të promovojë Shqipërinë si një vend me pasuri të jashtëzakonshme trashëgimie kulturore dhe potenciali turistik.

NDIHMJA E HUAJ NË 2009-2010

Totali i angazhimit donator arriti në 8.6 milion € grante, nga të cilat 6.3 milion € ose 73% janë lëvruar deri në fund të vitit 2010. Kjo mbështetje ka shënjestruar kryesisht trashëgiminë kulturore.

Figure 6.3 Angazhimet dhe lëvrimet e donatorëve për projektet që kanë filluar në 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Projektet kryesore që kanë filluar gjatë 2009-2010 janë: Programi i KE-së “Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe të Integruar të Trashëgimisë Kulturore dhe Historike - Faza II” me buxhet 5 milion €²³, që synon restaurimin dhe zhvillimin e vendeve të trashëgimisë kulturore dhe historike në qytet e Korçës, Elbasanit, Shkodrës dhe Beratit; Programi i Turqisë/TIKA për restaurimin e artefakteve historike në qarqe të ndryshme (1.5 milion €).

Projekte të tjerë të rëndësishëm janë: OKB, përmes agjencive të veta PNUD dhe UNESCO, mbështet dy programe: “Kultura dhe Trashëgimia për Zhvillimin Social dhe Ekonomik (CHSED)” dhe “Restaurimi i qendrës historike të Gjirokastrës”, me vlerë totale 3 milion €; Italia mbështet tre projekte: “Rehabilitimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë”, “Krijimi i Shkollës së Restaurimit” me 2.2 milion € dhe “Promovimi i ekoturizmit në Përmet” me 0.9 milion €. Përmes IPA 2008, KE ka angazhuar 0.8 milion € për forcimin e kapaciteteve të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe zyrave të saj rajonale për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit.

NISMAT E REJA TË DONATORËVE

Gjatë vitit 2011, Suedia do të fillojë fazën e dytë të Projektit “Kulturë pa Kufij” me një fond prej 0.94 milion €, i cili mbështet planifikimin urban përmes restaurimit të godinave dhe kontribuon në të kuptuarit e vlerave të trashëgimisë kulturore. Turqia/TIKA do të mbështesë trajnimin e punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Turizmit në 2011.

23 E gjithë shuma është kontraktuar.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Ruajtja, restaurimi, mbrojtja dhe promovimi i pasurive të trashëgimisë kulturore
- Forcimi i mekanizmave ligjorë, kapaciteteve dhe infrastrukturës për t'i dhënë shtysë trashëgimisë kulturore
- Hartimi i Planit Kombëtar për Zhvillimin e Turizmit

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Pika fokale e donatorëve e GSP-së për Turizmin është PNUD-i. Në kuadrin e zbatimit të nismën “Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës”, Gjermania do të vazhdojë të jetë donator aktiv dhe ta mbështesë këtë sektor.

Zhvillimi Rajonal dhe Decentralizimi

PANORAMA E SEKTORIT


Qeveria ka identifikuar nevojën për një politikë rajonale koherente dhe të integruar, e cila duhet të adresojë thellimin e hendeqeve soci-ekonomike në shoqëri dhe pakësimin e pabarazive mes qarqeve. Strategjia ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal (2007-2013) parashtrohet kuadrin strategjik për zhvillimin e sektorit dhe kalendarin për arritjen e objektivave. Ligji buxhetor 2009 miratoi një instrument të ri të politikës kombëtare për zhvillimin rajonal, duke krijuar Fondin për Zhvillimin Rajonal, përfshi edhe një zë të veçantë buxhetor për zhvillimin e rajoneve. Fondi për Zhvillimin Rajonal shërben si mekanizëm për financimin e projekteve brenda territorit të njësive të qeverisjes vendore dhe zbatohet prej tyre. Bashkitë dhe komunat kanë të drejtë të aplikojnë për këtë fond, i cili përbëhet nga grante konkurruese për infrastrukturën vendore, arsimin, shëndetësinë, objektet kulturore, sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, ndërtimin e tregjeve agro-ushqimore, vaditja, kullimi ndhe pyllëzimi.

Në dhjetor 2010, Qeveria miratoi vendimin për zbatimin e Nomenklaturës “Shqipëria në tri rajone NUTS II”, sipas njësive territoriale për qëllime statistikore (NUTS) që përdoret në BE. Në bazë të këtij Vendimi, janë identifikuar tri ndarje territoriale që konsiderohen rajone NUTS 2 (Durrësi dhe Veriu i Shqipërisë; Tirana dhe Elbasani; Jugu i Shqipërisë).

NDIHMA E HUAJ NË 2009-2010

Kontributet donatore për sektorin gjatë periudhës 2009-2010 tejkalojnë 13 milion €. Donatorët kryesorë kontribuues janë Zvicra (4.9 milion €), Austria (3 milion €), Suedia (1.7 milion €) dhe KE-ja (1.2 milion €).

Figura 6.4 Zhvillimi Rajonal dhe Decentralizimi – Angazhimet dhe Lëvrimet 2009-2010 (milion €)



Burimi: Baza e të dhënave e donatorëve 2011

Projektet e filluara gjatë 2009-2010 janë: Austria dhe Zvicra bashkëfinancojnë zhvillimin rajonal të veriut të Shqipërisë (4.2 €), duke përgatitur një Program Zhvillimi Rajonal të përbashkët për qarkun e Lezhës dhe Shkodrës; Faza II e programit të Zvicrës që mbështet decentralizimin dhe zhvillimin vendor të rajonit Shkodër-Lezhë (DLDP II) (3.1 milion €); KE/CARDS dhe PNUD kanë bashkëfinancuar projektin “Mbështetje e Integruar për Decentralizimin” me buxhet 5.2 milion €, i cili synon plotësimin e kuadrit ligjor dhe politik si dhe krijimin e agjencive të zhvillimit kombëtar dhe rajonal. Vlen të përmendet kontributi prej 1.7 milion € i këtij projekti për Fondin e Zhvillimit Rajonal që mbështet projektet në fushën e arsimit, infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve, trashëgiminë kulturore dhe shëndetin në nivel vendor.

Projekti kryesor që ka qenë në vazhdim gjatë kësaj periudhe është ai i SHBA-së, “Pushteti Vendor dhe Decentralizimi në Shqipëri (LGDA)” me rreth 5 milion €, që ka asistuar bashkitë që të planifikojnë dhe të përdorin më mirë mundësitë për investime, si edhe të menaxhojnë me efikasitet burimet publike. Programi holandez në qarkun e Dibrës (4.15 milion €) u ka dhënë financim të drejtpërdrejtë nismave vendore si rehabilitimi i rrugëve, ndërtimi i sistemeve të vaditjes dhe kanalizimeve, si edhe zhvillimit të tregjeve për tregti.

PRIORITETET E ARDHSHME

- Forcimi i rolit të Këshillit Rajonal
- Përgatitja e kuadrit ligjor për transparencën dhe përgjegjshmërinë e pushtetit vendor
- Forcimi i kapaciteteve për të pasur akses në fondet e BE-së dhe për t'i menaxhuar ato

BASHKËRENDIMI I DONATORËVE

Zyra e Bashkëpunimit Zviceran është pika fokale donatore e GSP-së për Decentralizimin dhe Zhvillimin Rajonal si edhe donatori evropian kryesor në kuadrin e nismës “Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës”. KE, Austria, Gjermania dhe Suedia do të vazhdojnë të jenë donatorë aktivë në këtë sektor.

6

PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Që nga raportimi i parë në 2005, Shqipëria ka përmbytur objektivat për 5 nga 15 indikatorët dhe ka bërë progres të konsiderueshëm për 3 indikatorë. Progres është arritur në zotërim, në menaxhim për rezultate dhe në përgjegjshmëri të përbashkët që përbën bazën për përshejtimin e punës për të përmbytur edhe indikatorët e tjerë. Përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013 dhe i nismave që lidhen me të, kanë krijuar mekanizma specifikë për të lehtësuar rritjen e efektivitetit të ndihmës. Në Tabelën 7.1 jepen shifrat e raportimit të vitit 2005 si edhe rezultatet e Anketave 2008 dhe 2011 të OECD/DAC, bashkë me objektivat 2010. Kjo shërben si orientim se ku Qeveria dhe donatorët duhet të fokusohen përpjekjet e tyre për të përmirësuar menaxhimin e ndihmës së huaj.

Table 7.1 Indikatorët e Deklaratës së Parisit: vlerat në 2005 dhe objektivat 2010

	Indikatorët	Referenca 2005	2007	Faktike 2010	Objektivi 2010
	PRONËSIA				
1	Strategjitë e Zhvillimit Operacional	C	C	B	B or A
	POZICIONIMI				
2a	Sisteme të besueshme të Menaxhimit Financiar Publik (MFP)	4.0	S'ka	S'ka	4.5
2b	Sisteme të besueshme prokurimi	S'ka	Nuk aplikohet	C	S'ka
3	Flukset e ndihmës të përshtatura me prioritetet kombëtare	32%	73%	86%	85%
4	Forcimi i kapaciteteve me mbështetje të bashkërenduar	28%	51%	58%	50%
5a	Përdorimi i sistemeve MFP	14%	12%	11%	43%
5b	Përdorimi i sistemeve të prokurimit	6%	10%	10%	S'ka
6	Forcimi i kapaciteteve duke shmangur NjZP-të (PIUs) paralele	57	24	18	19
7	Ndihma është më e parashikueshme	49%	29%	56%	74%
8	Ndihma pa imponimin e vendit ku të blihen mallrat	65%	78%	64%	Mbi 65%
	HARMONIZIMI				
9	Përdorimi përjasjeve me bazë programi	5%	14%	22%	66%
10a	Misionet e Përbashkëta	9%	29%	18%	40%
10b	Puna e përbashkët analitike	22%	34%	26%	66%
	MENAXHIM PËR REZULTATE				
11	Korniza të orientuara drejt rezultateve	D	D	C	B ose A
	PËRGJEGJSHMËRIA E PËRBASHKËT				
12	Përgjegjshmëria e përbashkët	N	N	Y	Y

Pronësia: Liderhip efektiv në lidhje me strategjitë dhe politikat e zhvillimit, si dhe bashkërendim i aksioneve për zhvillim

Qeveria e ka konsoliduar pronësinë dhe rolin e vet në bashkërendimin e ndihmës së huaj që nga krijimi i DEBASKON-it në vitin 2005. Shqipëria e përmirësoi vlerësimin nga C në 2005 dhe 2007, në B në 2010²⁴. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013 mundësoi pjesëmarrje dhe konsultime të gjera, përfshi grupe pune dhe këshillimore me përfaqësues të qeverisë, donatorëve, akademikëve dhe shoqërisë civile. SKZHI nxit vendimmarrjen e decentralizuar ku të përfshihen sa më shumë pjesëmarrës. SKZHI siguron lidhje efektive me vizionin afatgjatë dhe strategjitë sektoriale. Objektivat e SKZHI-së janë të prioritizuara dhe Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) zbaton SKZHI-në duke integruar procesin e buxhetit.

- **Arritje:** Zhvillimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013, përfshi monitorimin e brendshëm. Përgatitja pjesëmarrëse dhe kontributi i aktorëve kryesorë për SKZHI-në;
- **Sfidat:** Përgatitje pjesëmarrëse e qëndrueshme dhe kontributi i aktorëve kryesorë për SKZHI-në e re 2013-2020;
- **Mësimet:** Përfshirja e aktorëve kryesorë në përgatitjen e SKZHI-së ndihmoi në reflektimin e interesave dhe shqetësimeve të tyre
- **Aksionet prioritare:** Të sigurohet pronësi përfshirëse dhe transparencë, si dhe të vazhdohet me përfshirjen e aktorëve kryesorë në procesin e hartimit të politikave

Pozicionimi: Donatorët bazojnë mbështetjen e tyre të përgjithshme mbi procedurat, institucionet dhe strategjitë e zhvillimit kombëtar

Janë përmbytur disa nga objektivat e Deklaratës së Parisit që kanë të bëjnë me pozicionimin, përfshi ndihmën për buxhetin, bashkëpunimin e bashkërenduar teknik dhe pakësimin e numrit të NjZP-ve paralele. Përshtatja/ pozicionimi më i madh i ndihmës së huaj me prioritetet strategjike kombëtare dhe procesin e buxhetimit, përbën një objektivi kyç të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Krijimi i Grupeve Sektoriale të Punës ka kontribuar në forcimin e përshtatjes së ndihmës së huaj dhe bashkërendimit mes Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve. Nismat për digjitalizimin e sistemit financiar të qeverisjes pritet të kenë efekte pozitive në të ardhmen. Vlerësimi i sistemeve të prokurimit, duke përdorur Metodologjinë për Vlerësimin e Sistemeve të Prokurimit të përgatitur nga Task Forca e OECD-DAC për Prokurimin, tregon rritje nga niveli D në vitin 2006, në nivelin C në 2009, gjë që tregon se Shqipëria mund të ketë arritur tashmë objektivin për t'u ngjitur të paktën me një shkallë nga D të C. Sidoqoftë, përdorimi i MFP-së dhe sistemeve të prokurimit mbetet akoma sfidë.

- **Arritje:** Krijimi i prokurimeve kombëtare elektronike dhe sistemi MFP rriti transparencën dhe përputhshmërinë
- **Sfidat:** Donatorët ngurrojnë të përdorin sistemet shqiptare të prokurimit publik dhe të MFP-së
- **Mësimet:** Marrëveshjet strategjike mes donatorëve dhe qeverisë, si dhe formimi i Grupeve Sektoriale të Punës (GSP-të) japin efekte pozitive në përshtatjen e flukseve të ndihmës
- **Aksionet prioritare:** Duhet parashikime më të sakta për vëllimin dhe kohën e lëvrimeve të ndihmës; të identifikohet mënyra se si donatorët njoftojnë lëvrimin e fondeve, si dhe të bëhen të plota statistikatat shtetërore për ndihmat hyrëse

Harmonizimi: aksionet dhe aktivitetet donatore janë më të harmonizuara, transparente dhe më efektive në tërësi

Grupet Sektoriale të Punës konsiderohen instrument shumë eficient për të forcuar bashkërendimin, pasi luajnë rol të rëndësishëm në bashkërendimin e politikave dhe monitorimin e strategjive sektoriale, PBA-së dhe ndihmës së huaj.

GSP-të po përdoren si platformë diskutimi për mundësitë e programimit të përbashkët mes Qeverisë dhe donatorëve, si edhe për të analizuar potencialin e sektorit për zbatimin e Përqasjeve me Bazë Programi (PBP) apo Përqasje me Bazë Sektoriale (PBS). Vihet theksi në rritjen e liderhipit të ministrive të linjës në GSP-të, me qëllim që të lehtësohet përdorimi sa më i gjerë i PBP/PBS-ve. Mjaft donatorë po punojnë me Qeverinë shqiptare për ta përshtatur ndihmën sipas PBP-ve. Qeveria synon të forcojë rolin e Grupeve Sektoriale të Punës (GSP-ve), në mënyrë që të shtohet përdorimi i PBP-ve, sidomos në arsim, mjedis, bujqësi dhe transport. Miratimi i nismës “Pista e Shpejtë mbi Ndarje e Punës” më 31 maj 2011, ka për qëllim të mbështetë Shqipërinë në procesin e zbatimit të ndarjes së punës. Qëllimi final është të arrihen rezultate më të mira zhvillimi përmes ndihmës më efektive, koherencës së asistencës së BE-së, pakësimit të mbivendosjeve, uljes së kostove të transaksioneve, etj.

²⁴ Vlerësimi është me 5 germa nga A (nota më e lartë) deri në E (nota më e ulët). Deklarata e Parisit synon që 75% e vendeve partnere të arrijnë vlerësimin A ose B deri në vitin 2010

- **Arritje:** Zbatimi i Pistës së Shpejtë mbi Ndarjen e Punës pakëson fragmentimin e ndihmës dhe ndihmon në përcaktimin e përgjegjësive mes donatorëve
- **Sfidat:** Rritja e leadershipit të ministrive të linjës në GSP-të; Rritja e numrit të misioneve të përbashkëta dhe të punëve analitike të përbashkëta; Zbatimi i Pistës së Shpejtë mbi Ndarjen e Punës dhe shtrirja e saj jo vetëm te donatorët europianë, por te i gjithë komuniteti i donatorëve
- **Mësimet:** Formimi i Grupeve Sektoriale të Punës (GSP) kontribuon në bashkërendimin e donatorëve në misione dhe punë analitike, sidomos në sektorin e arsimit
- **Aksioni prioritar:** Qeveria duhet të kryejë një vlerësim të plotë dhe shqyrtim periodik të punës së përbashkët analitike. Krijimi i një mekanizmi formal për integrimin, rregullimin dhe bashkërendimin e PBP-ve, misioneve dhe punës analitike të përbashkët mes donatorëve në të gjithë sektorët.

Menaxhimi për rezultate: donatorët e vendet partnere menaxhojnë burimet, përmirësojnë vendimmarrjen

Në vitin 2010 u arriti rezultati i përgjithshëm C për kornizën e orientuar drejt rezultateve, duke shënuar përmirësim nga niveli D në vitin 2007²⁵. Ky vlerësim pasqyron progresin e fuqishëm që Shqipëria ka bërë dhe përpjekjet për të rikonfiguruar Sistemin e Raportimit dhe Monitorimit të Bazuar në Rezultate, i cili ishte i fokusuar në zbatim, por që po ri-fokusohet për të ofruar një kornizë solide të orientuar drejt rezultateve. Hapa të mëdhenj përpara janë bërë në këto fusha: zhvillimi i një sistemi për mbledhjen e të dhënave kombëtare për të gjeneruar informacion cilësor për monitorim të saktë, si dhe përhapja më e mirë e informacionit dhe të dhënave për qeverinë dhe aktorët kryesorë.

- **Arritje:** Zhvillimi i Sistemit të Raportimit dhe Monitorimit të Bazuar në Rezultate për SKZHI-në, që fokusohet në një kornizë të orientuar drejt rezultateve. Informacioni dhe të dhënat kombëtare janë bërë më të aksesueshme për donatorët dhe aktorët kryesorë shtetërore
- **Sfidat:** Zbatimi i plotë i sistemit të sapokrijuar të monitorimit të bazuar në Rezultate për SKZHI-në
- **Mësimet:** Monitorimi përmes një kornize të orientuar drejt rezultateve ofron monitorim më të mirë sesa ai i bazuar në zbatim
- **Aksioni prioritar:** Vazhdimi i përgatitjes së Sistemit të Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPSIS) dhe i Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Ndihmës së huaj (EAMIS) për të forcuar planifikimin strategjik, analizën e politikave, monitorimin, vlerësimin dhe bashkërendimin e donatorëve.

Përgjegjshmëria e përbashkët: donatorët dhe vendet partnere janë përgjegjëse për rezultatet e zhvillimit

Qeveria bashkë me komunitetin e donatorëve ka ngritur me sukses një sistem përgjegjshmërie të përbashkët, që është Plani i Veprimit për Harmonizim (PVH). PVH është përgatitur dhe miratuar nga qeveria dhe komuniteti i donatorëve në nëntor 2009. Raporti i progresit për arritjen e objektivave të përfshirë në PVH, është përgatitur dhe është prezantuar në Tryezën e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë të qershorit 2010. Komuniteti donator dhe qeveria ranë dakord bashkërisht që të thellojnë angazhimin në fushat kyçe të Deklaratës së Parisit dhe Agjendës për Veprim të Akrës, si edhe që të bashkojnë forcat për zbatimin e Deklaratës së Parisit. PVH nuk merret thjesht me harmonizimin në kuptimin e ngushtë të miratimit të procedurave të përbashkëta dhe shkëmbimi i përfundimeve analitike mes donatorëve, por me një rang të gjerë masash që kanë peshë në efektivitetin e ndihmës. Zbatimi i suksesshëm i PVH-së është i qartë nga përdorimi prej qeverisë i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) për të forcuar pronësinë e bashkërendimit të donatorëve, si edhe nga përmirësimin i pronësisë ndaj politikave në nivel sektori falë përdorimit të Përqasjeve me Bazë Sektoriale (PBS) dhe Pistës së Shpejtë mbi Ndarjen e Punës. Si rezultat, është rritur përgjegjësia individuale dhe kolektive e donatorëve ndaj qeverisë dhe mund të përmirësojnë bashkërendimin në nivel sektori.

- **Arritje:** Përgatitja dhe zbatimi i një sistemi të përgjegjshmërisë së përbashkët, dhe i Planit të Veprimit për Harmonizim (PVH)
- **Sfidat:** PVH duhet të funksionojë përkrah SPI-së për të formuar një “lak” që ngushton hapësirën e fragmentimit të donatorëve
- **Mësimet:** Me PVH, është rritur përgjegjësia individuale dhe kolektive e donatorëve ndaj qeverisë dhe mund të përmirësojnë bashkërendimin në nivel sektori.
- **Aksioni prioritar:** Të zbatohet plotësisht PVH.

²⁵ Shqipëria e ka arritur objektivin duke u ngjitur një shkallë (nga D te C) në 2010, por ende nuk ka përmbushur objektivin ndërkombëtar A ose B, të vendosur nga OECD

SHTOJCAT

SHTOJCA 1. VENDIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 775, DATË 24.09.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 775, datë 24.9.2010

PËR

ADMINISTRIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 39 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 26 të ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sigurimi dhe administrimi i financimeve të huaja, si pjesë përbërëse dhe /ose e raportuar në sistemin buxhetor të Republikës së Shqipërisë, është objekt i këtij vendimi.
2. Financime të huaja janë të gjitha huatë, kreditë dhe grantet që merr Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë nga shtetet e huaja, organizmat ndërkombëtarë, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat e huaja, organizatat joqeveritare etj.
3. Marrëveshje qeveritare kuadër janë marrëveshjet/protokollet që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja, për sigurimin e bashkëpunimit financiar apo bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet
4. Marrëveshje qeveritare janë marrëveshjet që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të shteteve të huaja, për sigurimin e financimit të projekteve të investimeve publike në Republikën e Shqipërisë.
5. Marrëveshje financimi janë marrëveshjet e huas/kredisë apo grantit që lidhen ndërmjet Republikës së Shqipërisë apo Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kreditorëve ose donatorëve të huaj, për financimin e projekteve të investimeve publike në Republikën e Shqipërisë.
6. Mbështetur në analizën dhe vlerësimin e situatës ekonomike e financiare të vendit, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave, miraton çdo vit programin buxhetor afatmesëm (PBA), si pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar (SPI). Programi buxhetor afatmesëm parashikon tërësinë e projekteve të investimeve publike, përfshirë edhe ato me financime tërësisht të huaja ose bashkëfinansim me buxhetin e shtetit, për çdo program, në një periudhë trevjeçare.
7. Koordinimi i projekteve me financim të huaj bëhet në përputhje me procedurat e sistemit të planifikimit të integruar (SPI), miratuar me vendimin nr.692, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave. SPI-ja është kuadri kryesor kombëtar për hartimin e politikave dhe planifikimin financiar, përcaktimin e përparësive strategjike të zhvillimit dhe integritit të vendit dhe alokimin e burimeve të brendshme e financimeve të huaja, në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar.

8. SPI-ja, nëpërmjet kuadrit strategjik, në bazë të të cilit përcaktohen përparësitë për financim të huaj, bazohet në përparësitë e programit të qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, të përditësuar, strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe planit kombëtar për zbatimin e MSA-së.
9. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) pranë Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritimit, koordinon procesin e identifikimit, diskutimit dhe përzgjedhjes së përparësive strategjike duke u këshilluar me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore të pavarura.
10. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), përmes mekanizmave dhe procedurave të përcaktuara në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), orienton programet afatgjata dhe afatmesme të financimeve të huaja dhe miraton listën e projekteve të reja parësore, për çdo sektor. Lista e projekteve parësore, e miratuar në parim, nga KPS-ja, do të përdoret në vijimësi nga Ministria e Financave dhe DEBASKON-i, në negociatat me huadhënësit/dhuruesit, për financime të reja.
11. Ministria e Financave është institucioni i vetëm që ka të drejtë të kërkojë dhe të sigurojë financime nga huadhënësit dhe dhuruesit, në formën e huave dhe granteve, që janë bashkëfinancim me hua. Në rastet e sigurimit të financimeve vetëm me grant ose kur granti është bashkëfinancim me fonde buxhetore, ky proces kryhet nga DEBASKON-i në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritimit.
12. Përgjegjësitë e institucioneve për ndjekjen e procedurave për përfundimin e marrëveshjeve qeveritare kuadër, marrëveshjeve të financimit dhe marrëveshjeve qeveritare, janë si vijon:
 - a) Për marrëveshjet qeveritare kuadër dhe marrëveshjet e financimit, Ministria e Financave dhe DEBASKON-i janë, përkatësisht, palë kryesore në negociata, në varësi të llojit të financimit, me hua apo grant. Në grupin e negocimit marrin pjesë edhe përfaqësues të ministrive përkatëse të linjës.
 - b) Për marrëveshjet qeveritare, procesi i negocimit udhëhiqet nga DEBASKON-i, i cili bashkëpunon me ministritë e linjës dhe Ministrinë e Financave. Nga kjo pikë bën përjashtim negociimi i financimeve nga Programi i Asistencës së Paraaderimit (IPA) nga BE-ja, proces, i cili udhëhiqet nga Ministria e Integritimit.
 - c) Pas negocimit, Ministria e Financave në bashkëpunim me DEBASKON-in, paraqesin për miratim në parim në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet qeveritare kuadër të negociuara.sdf
 - ç) Pas negocimit, ministritë e linjës përfituese, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, paraqesin për miratim në parim, në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet qeveritare dhe marrëveshjet e financimit të negociuara.
 - d) Ministri i Financave, në bazë të plotfuqisë për nënshkrim, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, nënshkruan marrëveshjet qeveritare kuadër dhe marrëveshjet e financimit.
 - dh) Ministrat përkatës të linjës, në bazë të plotfuqisë për nënshkrim, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, nënshkruajnë marrëveshjet qeveritare.
13. Institucionet përfituese (qendrore dhe vendore), janë përgjegjëse për të parashikuar në buxhetin e tyre të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse të financimit, të miratuara.
14. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve qeveritare kuadër, marrëveshjeve të financimit dhe marrëveshjeve qeveritare, institucioni nënshkrues ndjek procedurat e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve përkatëse.
15. Ministria e Financave dhe DEBASKON-i shkëmbejnë informacionin me huadhënësit/dhuruesit dhe përfituesit e financimeve të huaja lidhur me huatë/grantet e marra, masën dhe destinacionin e përdorimit të tyre.
16. DEBASKON-i dhe Ministria e Financave mbikëqyrin ministritë e linjës, për përmbushjen e kushteve të vendosura në marrëveshjet me huadhënësit dhe/ose dhuruesit dhe për progresin e bërë në zbatimin e projekteve përkatëse.
17. Ministria e Financave ndjek, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huatë dhe grantet. Ministritë dhe institucionet qendrore e vendore janë të detyruara t'i raportojnë Ministrisë së Financave të gjitha të dhënat e kërkuara, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave dhe granteve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor.

18. Të gjitha të ardhurat nga huatë dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huatë dhe grantet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuruuesi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave.
19. Shpenzimi i huave dhe granteve të livruara do të regjistrohet në shpenzimet e Buxhetit të Shtetit. Transferimet në llogaritë e përfituesve kryhen nga llogaritë e sistemit të thesarit në bankat e nivelit të dytë. Kur huatë dhe grantet livrohen në natyrë ose menaxhohen drejtpërdrejt nga dhuruesit, të regjistrohen në të njëjtën kohë si të ardhura (të hyra) në buxhet dhe si shpenzime (të dala), në bazë të njoftimit të pagesave të kryera për blerjen e mallrave ose shërbimeve përkatëse dhe konfirmimit të përfituesit.
20. Ministrinë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë ndihmë financiare apo materiale nga fondacione, shoqata, ndërmarrje, individë të ndryshëm etj., detyrohen që menjëherë, të raportojnë në Ministrinë e Financave. Mosraportimi në kohë ngarkon me përgjegjësi drejtuesin e institucionit dhe i jep të drejtë Ministrisë së Financave të rishikojë deri në pakësimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara për vlerën e ndihmës së përfituar.
21. Ministrinë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë për projekte të ndryshme hua, grante apo ndihma materiale, rregullisht një herë në muaj, sipas afateve, raportojnë të dhënat në Ministrinë e Financave.
22. Brenda muajit janar dhe korrik të çdo viti, ministrinë e linjës i raportojnë DEBASKON-it për:
 - a) të dhënat për ecurinë e zbatimit të projekteve me financim të huaj, për vitin pararendës;
 - b) të dhënat për planifikimin e zbatimit të projekteve me financime të huaja, për vitin në vazhdim. Kjo përfshin si projektet që kanë filluar në vitin pararendës, ashtu edhe ato për të cilat financimi është i garantuar dhe zbatimi i tyre pritet të fillojë gjatë vitit në vazhdim;
 - c) projektpropozimet për financime të huaja, për projekte që mund të diskutohen në negociatat me donatorët, gjatë vitit në vazhdim.

Për të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, ministrinë e linjës informojnë edhe Ministrinë e Integritit, për projektet me mbështetje financiare nga fondet e BE-së.
23. DEBASKON-i, si njësi përgjegjëse e ngarkuar me mbajtjen e bazës së të dhënave të financimeve të huaja:
 - a) përditëson bazën e të dhënave me informacionin e ardhur nga ministrinë e linjës brenda muajit mars dhe muajit shtator të çdo viti;
 - b) përgatit raportin vjetor të monitorimit të financimeve të huaja, për vitin pararendës.
24. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme lidhur me procedurat që duhen ndjekur gjatë fazave të ndryshme të livrimit, shpenzimit, raportimit dhe shlyerjes së kredive dhe granteve.
25. Ngarkohen Ministria e Financave, DEBASKON-i, Ministria e Integritit dhe ministrinë e linjës, si dhe institucionet e tjera në varësi të pushtetit ekzekutiv qendror për zbatimin e këtij vendimi.
26. Vendimi nr.116, datë 24.2.1997 i Këshillit të Ministrave “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe granteve të huaja, që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

MINISTRI I FINANCAVE
RIDVAN BODE

SHTOJCA 2. MEMORANDUMI PËR FTI DOL

Memorandumi i mirëkuptimit

“Shpallja e nismës pista e shpejtë mbi ndarjen e punës në Shqipëri”

1. Hyrje

Nisma Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës (*FTI DoL*) u diskutua për herë të parë në dhjetor 2007, në Mbledhjen e Ekspertëve Teknikë të BE-së në Bruksel. Qëllimi i *FTI DoL* është të mundësojë zbatim gradual të “Kodit të Sjelljes të BE-së për Komplementaritetin dhe Ndarjen e Punës në Politikat e Zhvillimit” (maj 2007). Në maj 2008, Këshilli i BE-së bëri thirrje për më tepër përpjekje nga KE dhe Shtetet Anëtare për të shpejtuar ndarjen e punës në vendet partnere. Shqipëria dhe Maqedonia ishin të vetmet vende të rajonit të përzgjedhura për zbatimin e kësaj nisme. *FTI DoL* është përfshirë tashmë në “Kuadrin Operacional për Efektivitetin e Ndhmës” të BE-së (nëntor 2009).

Në Shqipëri, *FTI DoL* drejtohet nga Qeveria përmes Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON). Kjo nismë është e hapur për çdo Donator European që dëshiron të marrë pjesë, ashtu si edhe për Partnerët për Zhvillim dhe Integrim (PZHI) që mund të kontribuojnë në procesin e bashkërendimit në funksion të ndarjes së punës dhe komplementaritetit.

FTI-DoL duhet të shihet si vlerë e shtuar e mekanizmave bashkërendues ekzistues të krijuar nga Qeveria e Shqipërisë; si e tillë, është mishëruar në Planin kombëtar të Veprimit për Harmonizim.

Pas analizës së përbashkët të realizuar gjatë 2009 dhe fillimit të 2010, është rënë dakord për rolet dhe përgjegjësitë e donatorëve kryesorë në kuadrin e *FTI DoL*-së. Caktimi i Donatorit Kryesor për çdo sektor është bërë në bazë të shprehjes së interesit nga donatorët, si edhe bazuar në analizën sektoriale të DEBASKON-it për angazhimet e donatorëve.

2. Objektivi

FTI-DoL synon të mbështetë Shqipërinë në procesin e zbatimit të ndarjes së punës në vend. Qëllimi final është arritja e rezultateve më të mira të zhvillimit përmes përmirësimit të efektivitetit të ndihmës. Shtetet Anëtare të BE-së dhe KE do të bashkëpunojnë sistematikisht në terren, duke përdorur si referencë parimet e Kodit të Sjelljes të BE-së për Ndarjen e Punës. Objektivi kryesor është që përmes efektivitetit të ndihmës të rritet koherenca e asistencës së BE-së, të pakësohen mbivendosjet, të ulen kostot e transaksioneve, etj.

Nisma Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës synon të mbështetë zbatimin gradual të Kodit të Sjelljes të BE-së në Shqipëri. *FTI DoL* do të integrohet brenda strukturave ekzistuese të bashkërendimit donator (konkretisht GSP-të) të kryesuara nga Qeveria shqiptare, sidomos në sektorët më afër agjendës së integritimit european. Donatorët europeanë marrin pjesë në *FTI DoL* vullnetarisht.

3. Rezultatet e synuara

- Angazhimi i Qeverisë dhe donatorëve në procesin e Ndarjes së Punës.
- Forcimi i kapaciteteve të Qeverisë për të realizuar menaxhim ndihme të orientuar drejt rezultateve, përfshi procesin e Ndarjes së Punës.
- Forcimi i kapaciteteve të donatorëve për të zbatuar Ndarjen e Punës.
- Përcaktimi i Ndarjes së Punës dhe zbatimi
- Rritja e komunikimit ndërmjet zyrave qendrore të donatorëve dhe zyrave të tyre në Shqipëri për procesin e Ndarjes së Punës.
- Krijimi i mundësive për optimizimin e ndihmës së donatorëve.
- Identifikimi i mundësive për bashkëfinancim në rang kombëtar.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë

Qeveria e Shqipërisë

Lidershipi i qeverisë, pronësia dhe përshtatja e ndihmës me politikat qeveritare, procesi i planifikimit dhe cikli i buxhetit, janë elementë kyçë të Nismës Pista e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës. Në veçanti, Qeveria e Shqipërisë duhet:

- Të ketë vullnet të fortë politik dhe përkushtim për të udhëhequr agjendën e bashkëpunimit për zhvillim.
- Të identifikojë prioritetet kombëtare bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe detyrimet e Partneritetit European.
- T'u japë donatorëve mbështetjen e duhur në sektorët strategjik, me vëmendje të veçantë në agjendën e integritetit në BE dhe sektorët e *acquis*.
- Të garantojë respektim dhe komplimentaritet të plotë me proceset dhe kornizat e tjera ekzistuese, si Grupet Sektoriale të Punës apo tryezat e rrumbullakëta *ad hoc*.
- Të garantojë përfshirjen e aktorëve kryesorë, si ato joshtetërorë (OJF-të, sektori privat), autoritetet vendore, parlamenti, etj.
- Të ndërtojë sisteme monitorimi efektive, në bashkëpunim të ngushtë me donatorët pjesëmarrës.
- Të përshpejtojë rregullimin e procedurave juridike, financiare dhe administrative për të garantuar proces normal dhe të thelluar të Ndarjes së Punës, në një mjedis të favorshëm makroekonomik dhe rritjeje ekonomike.
- Të përkushtohet ndaj reformave dhe/ose të forcojë institucionet publike (sidomos Administratën Publike në ministrinë e linjës).

Facilituesi

Gjermania është facilituesi global për *FTI DoL*; Italisë i është roli i facilituesit në Shqipëri. Facilituesi duhet:

- Të mbështetë Qeverinë shqiptare për zhvillimin e asistencës dhe zhvillimin e instrumenteve për Ndarjen e Punës (si përcaktimi i flukseve të ndihmës donatore, vlerësimi i avantazheve relative që ofrojnë donatorët, etj.).
- Të mbështetë zhvillimin e një plani/udhërrëfyese/strategjie kombëtare për Ndarjen e Punës, për të cilën do të bihet dakord mes Qeverisë shqiptare dhe donatorëve.
- Të mundësojë zhvillimin e kapaciteteve të stafit të Administratës Publike shqiptare, që të jetë e aftë të udhëheqë agjendën e efektivitetit të ndihmës.
- Të zhvillojë instrumentet dhe orientim, si edhe të trajnojë stafin e donatorëve të interesuara, me qëllim krijimin e një mjedisi nxitës.

Donatori kryesor

Donatori european kryesor duhet të përkushtohet për të lehtësuar dialogun për politikat sektoriale dhe bashkërendimin e ndihmës ndërmjet donatorëve europianë dhe Qeverisë shqiptare në kuadrin e agjendës së para-anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Kështu, donatori european kryesor duhet:

- Të lehtësojnë zbatimin gradual të Kodit të Sjelljes të BE-së, duke inkurajuar përqendrimin në sektor dhe ndarjen e punës mes donatorëve europianë.
- Të mundësojë një qëndrim të përbashkët të donatorëve europianë në dialogun me Qeverinë shqiptare dhe donatorët e tjerë në lidhje me politikat sektoriale (duke i kushtuar peshën e duhur qëndrimeve të pakicës dhe interesave të ndryshme).
- Të promovojë dhe të bashkërendojë, në nivel sektori, shkëmbimin e informacionit relevant, ekspertizës teknike dhe praktikave më të mira, sidomos në lidhje me standardet e BE-së dhe kushtet e para-anëtarësimit.
- Të lehtësojë arritjen e konsensusit mes donatorëve europianë në lidhje me planifikimin strategjik të ndihmës së huaj, si edhe me përdorimin e instrumenteve që rrisin efektivitetin e ndihmës (p.sh. PBP, programimi, monitorimi dhe vlerësimi i përbashkët, etj., kur është e volitshme).
- Të kërkojë në mënyrë aktive komplimentaritetin ndërmjet ndihmës dypalëshe europiane dhe IPA-s, me qëllim nxitjen e mbështetjes efektive për zgjerimin.
- Të marrë përgjegjësi si pikë fokale e GSP-së në disa sektorë (ose nënsektorë) që janë relevantë për agjendën e para-anëtarësimit në BE, me kushtet që Qeveria shqiptare të vlerësojë avantazhet krahasuese.
- Të përkushtojë burimet e duhura për realizimin e këtyre detyrave dhe përgjegjësiëve..

Donatorët europianë kryesorë duhet të kenë besim te donatorët e tjerë europianë dhe te Qeveria shqiptare që do të përmbushin detyrat e tyre brenda periudhës 3-vjeçare, dhe performanca do të vlerësohet çdo vit.

5. Pjesëmarrësit në FTI- dol në Shqipëri²⁶

SHQIPËRIA	Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë
AUSTRIA	Ambasada e Austrisë në Shqipëri/Zyra e Bashkërendimit për Bashkëpunimin Teknik, ADA
BE	Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri
ITALIA	Ambasada e Republikës së Italisë në Shqipëri/Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim
SUEDIA	Ambasada e Suedisë, Zyra në Tiranë/Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim
ZVICRA	Ambasada e Zvicrës në Shqipëri / Zyra e Bashkëpunimit Zviceran
GJERMANIA	Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri

6. Lista e sektorëve dhe donatorët kryesorë përkatës

- Sektori: Ujësjellës-Kanalizimet
Donatori Kryesor: Austria – Zyra e Bashkërendimit për Bashkëpunim Teknik, ADA
- Sektorët: (i) Media dhe Shoqëria Civile; (ii) Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme (Të drejtat e Pronës; Anti-korrupsioni; Menaxhimi i Integruar i Kufijve; Migracioni; Policia, Krimi i Organizuar, Terrorizmi dhe Trafiqet; Gjendja Civile dhe Kartat e Identitetit); (iii) Infrastruktura e Cilësisë dhe Tregu i Brendshëm
Donatori Kryesor: BE – *Delegacioni i Bashkimit European*
- Sektorët: (i) Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
Donatori Kryesor: Gjermania – GIZ në Tiranë
- Sektorët: (i) Energjetika
Donatori Kryesor: Gjermania – KfW
- Sektori: Zhvillimi i Sektorit Privat
Donatori Kryesor: Italia – Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim
- Sektorët: (i) Mjedisi; (ii) Statistikat
Donatori Kryesor: Suedia – Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim
- Sektorët: (i) Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal; (ii) Punësimi/AFP
Donatori Kryesor: Zvicra – Zyra e Bashkëpunimit Zviceran

²⁶ Memorandumi i Mirëkuptimit për Pistën e Shpejtë mbi Ndarjen e Punës (FTI DoL) u nëshkrua më 31 maj 2010, ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministri i Inovacionit dhe TIK-ut, Genc Pollo dhe gjashtë donatorëve europianë pjesëmarrës: Italia (në rolin e facilituesit), Austria, Zvicra, Delegacioni i BE-së dhe Suedia. Gjermania e nënshkroi Memorandumin më vonë në 2010.

We hereby commit to launch the first Division of Labour (DoL) arrangements among European donors in Albania. Such arrangements will be implemented in a number of selected sectors, where a willing European lead donor has been identified, as detailed above in: List of Sectors and respective Lead Donor.


ADOPTED in Tirana, on 31 May 2010, from the participants of FTI - DoL in Albania

ALBANIA




Mr. Genc POLLO
Minister for Innovation and ICT
Government of the Republic of Albania

ITALY




His Excellency Mr. Saba D'ELIA
Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary
Embassy of the Republic of Italy
Tirana, Albania

AUSTRIA




His Excellency Mr. Florian RAUNIG
Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary
Embassy of Austria
Tirana, Albania

SWITZERLAND




Her Excellency Ms. Yvana ENZLER
Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary
Embassy of Switzerland
Tirana, Albania

DELEGATION OF THE EUROPEAN UNION



His Excellency Mr. Helmuth LOHAN
Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary
/ Head of Delegation
Delegation of the European Union
Tirana, Albania

SWEDEN



Ms. Elisabeth STAM
Chargé d'Affaires
Embassy of Sweden
Tirana, Albania

SHTOJCA 3. STRUKTURA E GRUPEVE SEKTORIALE TË PUNËS

Prioriteti Strategjik Fusha (sipas SKZhI)	GSP	Pika Fokale Donatore	Donatori kryesor në kuadrin e nismës FTI DoL	Ministria e linjës/Institucioni
Infrastruktura	Energjetika	BB	Gjermani/KfW	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	Transporti	BB		Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
	Uji	Austria (ADC)	Austria (ADC)	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
	Mjedisi	Suedia	Suedia	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
Ekonomia dhe Financat	Ekonomia-Zhvillimi i Sektorit Privat	BB	Italia	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	Ekonomia-Teknologjia e cilësisë/Tregu i Brendshëm		BE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	TIK	PNUD		Ministri i Inovacionit dhe TIK
	Statistikat	Suedia	Suedia	INSTAT
	Financat Publike	BB		Ministria e Financave
	Prokurimi Publik*			Agjencia e Prokurimit Publik
Zhvillimi Social	Sigurimet shoqërore	BB		Ministria e Financave Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
	Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale	OKB - (UNICEF për strategjitë e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale)		Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
	Punësimi dhe AFP	Bashkëpunimi Zviceran	Bashkëpunimi Zviceran	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Ministria e Arsimit dhe Shkencës
	Barazia Gjinore dhe Dhuna në Familje	UN WOMEN		Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
	Rinia dhe Kultura	OKB		Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
	Arsimi (ekskluzive AFP)	BB & UNICEF (vetëm për Arsimin Bazë)		Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
	Shëndetësia	OBSH		Ministria e Shëndetësisë

Prioriteti Strategjik Fusha (sipas SKZHI)	GSP	Pika Fokale Donatore	Donatori kryesor në kuadrin e nismës FTI DoL	Ministria e linjës/Institucioni Kryesuesi/Pika Fokale
Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme Konsorciumi Ndërkombëtar (Pika Fokale Donatore)	Drejtësia: Reforma Ligjore (përfshi dy nënGSP: Drejtësia për të Miturit dhe Reforma e Burgjeve)	SHBA dhe UNICEF për Drejtësinë për të Miturit	BE	Ministria e Drejtësisë
	Mbrojtja e Dëshmitarëve			Ministria e Drejtësisë
	Policia e Shtetit (Policia dhe Krimi i Organizuar)			Ministria e Brendshme
	Policimi në Komunitet / Parandalimi i Krimit			Ministria e Brendshme Policia e Shtetit
	Menaxhimi i Integruar i Kufijve dhe Migracioni			Ministria e Brendshme Policia e Shtetit (Policia Kufitare) Doganat Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
	Asistenca me Trajnim dhe Pajisje			Ministria e Drejtësisë Ministria e Brendshme Policia e Shtetit
	Menaxhimi i Informacionit dhe Teknologjia			Ministria e Drejtësisë Ministria e Brendshme
Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme	Të drejtat e pronës	Prezenca e OSBE-së në Shqipëri	BE	Ministria e Drejtësisë; ALUIZNI; ZRPP
	Anti-korrupsioni	Prezenca e OSBE-së në Shqipëri	BE	Këshilli i Ministrave, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Anti-korrupsion
	Parlamenti, Zgjedhjet dhe Gjendja Civile	Prezenca e OSBE-së në Shqipëri		Ministria e Brendshme
	Administrata Publike	PNUD, BB	BE	Ministria e Brendshme; Departamenti i Administratës Publike
	Media dhe Shoqëria Civile	BE	BE	
Zhvillimi Urban, Rural dhe Rajonal	Decentralizim dhe Zhvillimi Rajonal	Bashkëpunimi Zvicëran	Bashkëpunimi Zvicëran	Ministria e Brendshme; Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	Bujqësia, Ushqimi dhe Zhvillimi Rural	BB	Gjermania (GIZ)	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve
	Turizmi	OKB		Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
	Planifikimi Hapësinor dhe Strehimi	BB		Ministria e Punëve Publike dhe Transportit; Ministria e Brendshme

DEPARTAMENTI I BASHKËRENDIMIT
TË STRATEGJIVE DHE KOORDINIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
KËSHILLI I MINISTRAVE

Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr.1, Tiranë
Tel: + 355 4 2277 357
Fax: + 355 4 2226 354

koordinimi@km.gov.al
www.dsdc.gov.al